

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5974
E hënë, 13 janar 2020
çmimi 0.40 €

Sot fillon
gjysmëvjetori
i dytë IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI IFAQE 4-5

LDK-ja NA KËRKOI KRYEPARLAMENTARIN, NE IA OFRUAM MPJ-në



Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se negociatat me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për bashkëqeverisje kanë mbetur te posti i kryeparlamentarit. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se LDK-ja po këmbëngulë që t'i kthehet ky post. Sipas Bahtirit, LV-ja në këmbim të këtij posti ia ka ofruar LDK-së Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ai e ka ftuar liderin e LDK-së, Isa Mustafa,

që të reflektojë në këtë drejtim, duke shtuar se çështja e postit të kryetarit të Kuvendit është mbyllur tashmë. Bahtiri ka paralajmëruar se nuk do ta presin shumë LDK-në. Ai ka thënë se shumë shpejt Këshilli i Përgjithshëm i LV-së do t'i japë drejtim kësaj çështje

OPINION

GJASHTË VJET NGA FIRMOSJA
E DEKLARATËS PËR
BASHKËPUNIM DHE
PARTNERITET STRATEGJIK MES
KOSOVËS DHE SHQIPËRISË F. 11

Sylë
UKSHINI



AKTUALE

RRETH 28 MIJË DHURUES
VULLNETARË TË GJAKUT
NË KOSOVË F. 7

HARADINAJ JEP DORËHEQJE
EDHE NGA POSTI I KRYETARIT
TË AAK-së F. 5

EKONOMI

BIZNESET NUK PREFEROJNË
ARBITRAZHIN F. 8

VONESAT NË FORMIMIN E
QEVERISË, NGA 1 MARS NUK
REALIZOHET ASNJË PAGESË F. 9

KULTURË

THIMI MITKO DHE FILLIMET E
SHKENCËS SË ALBANOLOGJISË

F. 14-15

Prof. dr. Begzad
BALIU



SPORT

KOSOVA HUMBET MIQËSOREN
NË TË CILËN SHKËLQEU F. 20



Ngecin negociatat LV - LDK

IFAQE 3

Deli Balidemaj garon për Këshillin e qytetit të Munihut

IFAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Komisionari për zgjerim i BE-së më 16 shkurt viziton Shqipërinë



TIRANË, 12 JANAR - Oliver Varhelyi, komisionar evropian për zgjerimin, do t'i vizitojë më 15 dhe 16 janar Shkupin dhe Tiranën, në misionin e tij të parë zyrtar në Ballkanin Perëndimor që nga fillimi i mandatit të tij. Ai do t'i kryejë

disa takime me zyrtarë të lartë të politikës shqiptare më 16 shkurt, pas vizitës që do të zhvillojë një ditë më parë në Maqedoninë e Veriut.

Në Tiranë ai do të takohet me presidentin Ilir Meta, kryeministrin Edi Rama dhe kryetarin

e PD-së, Lulzim Basha.

Oliver Varhelyi është një nga mbështetësit e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për hapjen e negociatave.

Pak kohë më parë, ai kishte deklaruar se ka pasur diskutime "të hapura, konstruktive dhe

inkurajuese" me Francën dhe Holandën për zgjerimin e ardhshëm të BE-së me Ballkanin Perëndimor. Ai është shprehur se në pranverë duhet të punohet për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ditmir Bushati, i dërguar i posaçëm në OSBE

Ish-ministri i Jashtëm shqiptar Ditmir Bushati është caktuar i dërguar i posaçëm në OSBE, i cili do t'i mbulojë disa fusha dhe do të jetë kompetent për zgjidhjen e jo pak problematikave që karakterizojnë punën e këtij institucioni

TIRANË, 12 JANAR - Në faqen zyrtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), presidencën e së cilës këtë mandat e udhëheq Shqipëria, është njoftuar se ka caktuar ish-ministrin e Jashtëm shqiptar si të dërguar të posaçëm për këtë institucion ndërkombëtar. Po sipas këtij njoftimi, thuhet se ish-ministri shqiptar do t'i mbulojë disa fusha dhe do të jetë kompetent për zgjidhjen e jo pak problematikave që karakterizojnë punën e këtij institucioni sot. Bushati mbase do të mbahet mend për disa qëndrime kritike ndaj qeverisë Rama, përmendim këtu temën e shumë diskutuar për ndryshimin e kufijve të Kosovës, ku Bushati u shpreh hapur kundër kësaj lëvizje që publikisht u pranua që u iniciua

nga presidenti Thaçi dhe u mbështet edhe nga kryeministri Rama.

Ishte pikërisht Ditmir Bushati ai që në vitin 2015 ndryshoi Ligjin për Shërbimin e Jashtëm duke ndryshuar thujtë në mënyrë rrënjësore mënyrën se si bëheshin emërimet e punonjësve diplomatikë nëpër selitë përfaqësuese të Shqipërisë nëpër botë. Gjatë kohës që shërbeu si ministër jo vetëm që nuk e përmirësoi imazhin e vendit në arenën e jashtme, por i vuri shkelmin duke arritur rekordin e emërimeve politike nëpër seli diplomatike shqiptare, ku nga "tradita" që 20 % e punonjësve ishin njerëz me ngjyra politike, ai e rriti këtë shifër në thujtë 100 % të emërimeve me njerëz që i shërbenin atij dhe orientimit të tij politik. Po me anë të ndryshim-



it të ligjit të sipërcituar, Ditmir Bushati shënoi një rekord personal duke larguar diplomatët e karrierës, dhe duke i zëvendësuar ata me njerëz me të shkuar kriminale. Duke zhbërë kështu në mënyrë të parikuperueshme

atë pak imazh dhe profesionalizëm që kishin krijuar deri në atë vit përfaqësitë tona diplomatike.

Ishte pikërisht vetë Bushati që do të lobonte që Valdrin Pjetri të kandidonte dhe të emërohej

kryetar i Bashkisë Shkodër. Por çfarë ndodhi më pas? Sapo u bë publik kudo lajmi se Pjetri kishte shkelur Ligjin e Dekriminalizimit duke mos deklaruar një dënim të hershëm jashtë vendit, Bushati e braktisi atë dhe madje ju vu kundër edhe Ramës, duke ia faturuar të gjithë faturën atij dhe qeverisë.

Më në fund Rama e shkarkoi Bushatin nga posti i ministrit të Jashtëm, duke emëruar në vend të tij Gent Cakën.

E në fakt këtu nisën edhe "përplasjet" e Bushatit me qeverinë dhe kryesisht me kryeministrin, pasi tashmë ish-ministri kishte marrë dukshëm një pozicion kritik ndaj qeverisë ku deri pak më parë kishte bërë pjesë. Tashmë presionet e tij në Parlament e në media ndaj qeverisë ishin të vazhdueshme, sepse siç dukej atij i ishte prishur terezia. Edhe në kohën kur Parlamenti holandez kërkoi rivendosjen e vizave me Shqipërinë, ai sërish nuk nguroi që të kritikonte qeverinë për pozicionin që mbajti kjo e fundit pas vendimit të Holandës.

Presidenti Meta kthen në Kuvend paketën anti-shpifje

TIRANË, 12 JANAR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta ka refuzuar të dekretojë ligjin "antishpifje" të miratuar disa javë më parë nga mazhoranca socialiste. Ligji shumë i kritikuar nga gazetarët vendas, por edhe nga disa prej ambasadave të aleatëve strategjikë, është kthyer nga Meta në Kuvend.

Sipas Metës, ky ligj "shkel parimet themelore kushtetuese të një shteti demokratik, të drejtën e lirisë së shprehjes, së shtypit dhe të drejtës së informimit".

Presidenti e konsideron ligjin "në kundërshtim me jurispruencën e Gjykatës Kushtetuese", si dhe në shkelje të standardeve të Konventës

Evropiane të të Drejtave të Njeriut. "Kjo gjendje censure krijohet përmes aplikimit të masave ndëshkuese joproportionale që këto dispozita parashikojnë, masa që mund të vlerësohen dhe vendosen nga organe administrative, të cilat në kundërshtim të hapur me rendin e brendshëm kushtetues dhe ligjor, u jepet fuqia që t'i vënë në ekzekutim të menjëhershëm këto masa, përpara se të ketë një vendim-marrje përfundimtare dhe të formës së prerë mbi ligjshmërinë e tyre.

Hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve do të krijojë një mjedis arbitrar dhe të pasigurt ndaj operatorëve mediatikë elektronikë, për shkak të trys-

nisë së aplikimit pa kriter dhe subjektiv të masave ndëshkuese dhe shproporcionale që parashikon ligji i miratuar. Këto mekanizma joproportionale të forcës ndëshkuese që përmbajnë ndryshimet ligjore të miratuar, krijojnë hapësirë që ato të aplikohen përkundëjt medieve on line që janë kritike me punën e qeverisë. Kjo e fundit përmes përfaqësuesve të saj në organet vendimmarrëse dhe kompetencave që këto organe marrin, ka të gjitha mundësitë të shfrytëzojë këtë bazë ligjore që lejon interpretim subjektiv, të ndëshkojë në mënyrë të padrejtë çdo media e cila nuk i përshtatet vullnetit politik të shumicës.



Ky realitet do të prodhonte frikësimin dhe autocensurën, mbylljen apo pezullimin me pa të drejtë të medieve elektronike, duke ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë dhe objektivitetin e informacionit, ç'ka do të prodhonte furnizimin e

publikut me fakte ndryshe nga realiteti, që jo vetëm keqorientojnë shoqërinë në kërkimin e të drejtave të tyre, por dhe në përmbushjen e përgjegjësisë qytetare për ndërtimin dhe ruajtjen e vetë demokracisë", thuhet në dekretin e Metës.

Ngecin negociatat LV - LDK



Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sot hyjnë në ditën e katërt pa zhvilluar asnjë takim për arritjen e një marrëveshje për formimin e qeverisë së re. Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka treguar të dielën se i kanë bërë dy propozime të reja LDK-së, ndërkaq edhe kjo e fundit ka njoftuar se në mirëbesim dhe me vullnet për të arritur marrëveshje ia ka paraqitur ofertën LV-së për bashkëqeverisje. Por asnjëra palë nuk i ka bërë publike ofertat që ia kanë bërë njëra-tjetrës për formimin e qeverisë

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 JANAR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk kanë arritur pajtueshmëri për nënshkrimin e një marrëveshje për ta formuar qeverinë. As të premtën, as të shtunën dhe as të dielën nuk është realizuar asnjë takim mes zyrtarëve të këtyre dy partive për këtë qëllim. Ndërkaq të premtën presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ia ka kërkuar Lëvizjes Vetëvendosje emrin e kandidatit për kryeministër. Përmes një letre drejtuar liderit të LV-së, Albin Kurti, presidenti ka kërkuar që të njoftohet nëse Vetëvendosja do ta dorëzojë emrin e mandatarit për kryeministër apo do të refuzojë ta bëjë një gjë të tillë. Kjo e fundit nuk i është përgjigjur letrës së presidentit. Ndërsa njohësit e proceseve politike letrën e presidentit Thaçi e kanë parë si presion politik ndaj Kurtit për të arritur sa më shpejt marrëveshje me LDK-në.

Për negociatat me LDK-në të dielën ka folur lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili ka thënë se të mërkurën që lamë pas të dyja palët kanë bërë nga një propozim. "Pra, kishte lëvizje. Të enjten ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi bërë edhe dy

propozime të reja. Për propozimin tonë të fundit na është thënë se do ta trajtojnë në organet e tyre, meqenëse ky propozim ishte risi. Nuk mund të flas se cila është përmbajtja e tij dhe çfarë do të bëjmë ne, pasi kjo është pjesë e negociatave, unë mund të flas për atë se çka nuk do të bëjmë", ka thënë Kurti në takimin që ka pasur me e kryetarët e qendrave të kësaj lëvizje.

Kurti ka thënë se këto bisedime nuk janë të lehta. "Duhet t'i ruajmë nervat. Të punojmë e të angazhohemi por, me durim. Këto bisedime nuk janë të lehta. Edhe më të rënda na presin bisedimet në të ardhmen si qeveri me faktorë të ndryshëm", është shprehur ai.

Kurti ka thënë se sigurisht që kanë mundur dhe është dashur të arrihet marrëveshja me LDK-në deri më tash. "Unë jam ekspozuar dy herë në mënyrë të rrezikshme: më 26 dhjetor jam ekspozuar para dy milionë qytetarëve dhe gjithë deputetëve të Kuvendit, pa pasur marrëveshje me LDK-në dhe, mandej në takimin te presidenti sërish u detyrova të shkoj pa marrëveshje me LDK-në, por së paku kisha gjysmën e kabinetit tim të bërë publik. Mirëpo, unë e di se ajo që ju jeni të interesuar sot është të dini se ku ndodhemi tash dhe çfarë na pret në ditët në

vazhdim", ka thënë Kurti, duke shtuar se janë afruar me LDK-në. "Është e vërtetë se jemi afruar dhe, po u afruam edhe pak, do të bëjmë marrëveshje. Vullnet e interes kemi, por garanci nuk mund të jap sepse nuk varet nga unë. Jam i gatshëm të takohemi përditë, edhe të mbyllemi në ndonjë vend derisa të merremi vesh. Këtë mund ta them për veten, por jo për palën tjetër", ka deklaruar ai.

Lideri i LV-së ka bërë me dije se do të bëjnë shumëçka që të arrihet marrëveshja me LDK-në por, sipas tij, kjo marrëveshje duhet të arrihet gjithnjë përbrenda kornizave të Kushtetutës dhe ligjit, të demokracisë dhe të rendit republikan, të vullnetit të popullit të shprehur në zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Në LDK thonë se institucionet duhet t'i formojë partia fituese dhe janë në pritje të hapave që do të ndërmerren Vetëvendosja.

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Agim Veliu, ka thënë javën e kaluar se nuk janë aq afër arritjes së marrëveshjes me LV-në. Ai ka deklaruar se LV-ja duhet t'i marrë përgjegjësitë që i ka. "Ajo e ka përgjegjësinë që t'i themelojë institucionet, të marrë hapa, sepse ajo ka dalë partia e parë. LDK-ja i ka humbur zgjedhjet dhe nuk është

partia e parë. Është partia e dytë. Edhe duke qenë në këtë situatë do të thotë jemi të detyruar t'i presim hapat e LV-së, sepse ajo është përgjegjëse për themelimin të institucioneve. Nuk kisha thënë që jemi aq afër marrëveshjes", pati deklaruar Veliu për "Klan Kosova". LDK-ja ka njoftuar se në mirëbesim dhe me vullnet për të arritur marrëveshje, i ka paraqitur ofertën LV-së për bashkëqeverisje, duke mos treguar se çfarë ka përmbajtur kjo ofertë.

Për negociatat mes këtyre dy partive kanë folur edhe analistët politikë. Analisti politik Ramush Tahiri ka fajësuar Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për bllokim të marrëveshjes për bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje (LV). Ai ka thënë se është keq që nuk po ka rezultat për arritjen e marrëveshjes për koalicion në mes të LDK-së dhe LV-së. "Edhe më keq është që nuk po bëhen publike dallimet se për çka nuk po arrihet kjo marrëveshje. Opinioni me të drejtë ose pa të drejtë po konsideron se LDK-ja me kërkesat për shtatë ministri faktikisht po e bllokoi procesin e marrëveshjes, sepse po i vendos në pozitë shumë të keqe Albin Kurtin dhe LV-në. Se a është e vërtetë që LDK-ja po i kërkon shtatë ministri këtë do ta dimë nëse marrëveshja nuk arrihet përfundimisht, sepse atëherë palët duhet të tregojnë se ku i kanë pasur dallimet", ka thënë Tahiri. Ndërkaq analisti politik Artan Murati ka bërë me dije se vendi nuk ka nevojë për zgjedhje të reja. Ai ka deklaruar se është humbje kohe dhe degradim i një procesi të mirëfilltë zgjedhor nëse shkohet përsëri në

zgjedhje të parakohshme. Murati ka thënë se duhet të shterën të gjitha mundësitë kushtetuese e reale para se të mendohet për zgjedhje. "Është e papranueshme të flitet për zgjedhje të reja tre muaj pas një procesi të rregullt zgjedhor, vetëm pse subjektet politike nuk arrijnë t'i tejkalojnë dallimet e vogla për pozita të caktuara. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njeh edhe mundësinë e mandatimit të një kandidati tjetër për kryeministër nëse dështon mandatarin i parë. Konsideroj se duhet të shterën të gjitha mundësitë kushtetuese e reale para se të mendohet për zgjedhje sepse nuk kemi kaq shumë kohë për të humbur", ka thënë Murati. Ai ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës e kanë për obligim të arrijnë një marrëveshje bashkëpunimi për ta çuar në vend vullnetin e rreth 500 mijë votuesve të cilët votuan më 6 tetor. Sipas Muratit, të dy këto subjekte politike duhet të jenë realiste në kërkesat e tyre. "Nëse ka vullnet për ta shtyrë procesin përpara, e sidomos nëse reflektohet në vullnetin qytetar të 6 tetorit, sigurisht se mund të tejkalohen dallimet aktuale dhe mund t'i hapet rrugë një marrëveshjeje për bashkëqeverisje mes dy palëve. Që të dy subjektet duhet të jenë realiste në kërkesa. LV-ja nuk është fituese absolute e zgjedhjeve, e LDK-ja nuk i ka fituar ato. Pra, para se të ketë kërkesa maksimaliste nga të dyja palët, duhet të reflektohet në rezultatit real të zgjedhjeve. Kjo do ta lehtësonte arritjen e një marrëveshjeje të koalicionit", është shprehur Murati.



FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI

LDK-ja NA KËRKOI KRYEPARLAMENTARIN, NE IA OFRUAM MPJ-NË

Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se negociatat me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për bashkëqeverisje kanë mbetur te posti i kryeparlamentarit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se LDK-ja po këmbëngulë që t'i kthehet ky post. Sipas Bahtirit, LV-ja në këmbim të këtij posti ia ka ofruar LDK-së Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ai e ka ftuar liderin e LDK-së, Isa Mustafa, që të reflektojë në këtë drejtim, duke shtuar se çështja e postit të kryetarit të Kuvendit është mbyllur tashmë. Bahtiri ka paralajmëruar se nuk do ta presin shumë LDK-në. Ai ka thënë se shumë shpejt Këshilli i Përgjithshëm i LV-së do t'i japë drejtim kësaj çështje

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 JANAR - Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka treguar për kërkesat që Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka ndaj LV-së për ta arritur marrëveshjen për bashkëqeverisje. Ai ka deklaruar se partia e Isa Mustafës kërkon që t'i kthehet posti i kryeparlamentarit ashtu siç ishin pajtuar fillimisht. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka bërë me dije se një gjë e tillë është e paarritshme. "Pasi kemi rifilluar bisedimet ata këmbëngulin që t'u kthehet posti i kryeparlamentarit. Mendoj se ata duhet ta kuptojnë se kjo

çështje tashmë ka përfunduar. Kjo kërkesë nuk është në rregull, sepse t'i humbësh zgjedhjet dhe ta kërkoh postin e kryeparlamentarit nuk është e drejtë. Po ashtu, ta kërkoh postin e presidentit, duke mos përmendur asnjë emër, as kjo nuk është në rregull. Tani bisedimet kanë mbetur te kryeparlamentari", ka thënë Bahtiri. Ai ka treguar se LV-ja në këmbim të postit të kryeparlamentarit të LDK-së i ka ofruar Ministrinë e Punëve të Jashtme. "Si anëtar i LV-së kam propozuar që si kompensim për postin e kryetarit të Kuvendit t'i jepet LDK-së Ministria e Punëve të Jashtme. Ndërsa kur të zgjedhet presidenti në vitin 2021, MPJ-ja t'i kthehet LV-së dhe të vazhdojmë qeverisjen me nga pesë ministri", ka thënë ai, duke shtuar se

ende nuk kanë marrë një përgjigje nga LDK-ja për këtë çështje. Për zvarritjen e këtyre negociatave për formimin e qeverisë, Bahtiri ka fajësuar liderin e LDK-së, Isa Mustafën. "Këto lojëra të Isa Mustafës unë nuk po mund t'i kuptoj dhe nuk po i kupton asnjë njeri. Kështu që, kemi mbetur në një situatë jashtëzakonisht të keqe", është shprehur ai. Sipas Bahtirit, LV-ja nuk do ta presë shumë LDK-në. Ai ka thënë se shumë shpejt Këshilli i Përgjithshëm i LV-së do t'i japë drejtim kësaj çështje. "Në fund do të marrë vendim Këshilli i Përgjithshëm i LV-së dhe atë vendim ju si media sigurisht se do ta shihni. Ne nuk dëshirojmë që ta bllokojmë shtetin dhe nuk do ta bëjmë një gjë të tillë. Ne do



të presim edhe pak, por jo shumë", është shprehur Bahtiri.

"Epoka e re": Z. Bahtiri, pse nuk ka ende marrëveshje LV-LDK?

Bahtiri: Nuk kemi marrëveshje sepse LDK-ja ende nuk po mund ta kuptojë se çfarë qëllimi ka në këto bisedime. Ne çdoherë kemi qenë të hapur dhe zemërgjerë për të ecur përpara dhe për të bërë koalicion me LDK-në, në mënyrë që t'i përmbushim pritjet e qytetarëve që kanë votuar më 6 tetor.

LDK-ja në këto bisedime çdoherë bën kërkesa të ndryshme dhe asnjëherë nuk tregohet e vendosur për t'i përfunduar gjërat. Siç dihet ne ia kemi dhënë fillimisht postin e kryeparlamentarit, por nuk e desh. Pastaj, ne kërkuam që kryeparlamentarin ta votojmë në ditën që u mbledh Kuvendi dhe prapë ajo nuk dëshiroi. Kur e propozuam kandidatin tonë për kryeparlamentar e votoi. Ndërsa, tani dëshiron ta kthejë kryeparlamentarin. Këto lojëra të Isa Mustafës unë nuk po mund t'i kuptoj dhe nuk po i kupton asnjë njeri. Kështu që, kemi mbetur në një situatë jashtëzakonisht të keqe. Prandaj, thirrjet e mia për një marrëveshje të shpejtë kanë qenë shumë reale dhe njerëzore, sepse e kemi obligim t'i krijojmë institucionet ndaj qytetarëve të cilët na kanë votuar.

"Epoka e re": Cilat janë kërkesat LDK-së për ta arritur marrëveshjen?

Bahtiri: Siç e dini, në fillim jemi pajtuar me një qeverisje ku secila parti t'i ketë nga pesë ministri. Isa Mustafa ministrinë e parë që ka zgjedhur ka qenë ajo e MPB-së, të cilin vazhdimisht LV-ja kishte proklamuar se do ta merrte për t'i luftuar krimin dhe korrupsionin. Pavarësisht kësaj, ne ia besuam këtë ministri LDK-së. Pasi përfundoi ndarja e ministrive, LDK-ja kërkoi që t'i jepet kryeparlamentari dhe posti i presidentit. Qëndrimet tona rreth postit të presidentit kanë qenë që njëherë mos të flitet për këtë çështje derisa të vijë koha e zgjedhjes së presidentit. Ndërsa postin e kryepalamentarit ua kemi ofruar, ani pse ai post i takon partisë që ka fituar zgjedhjet. Ata nuk e pranuan ofertën tonë dhe pasi u thirr mbledhja konstituive e Kuvendit ne ishim të obliguar ta konstituojmë këtë institucion dhe t'i hapim rrugë krijimit të institucioneve të reja. Pra, ne propozuam kandidatin tonë, z. Konjufca, i cili u zgjedh me 75 vota, duke përfshirë të gjitha votat e LDK-së.

"Epoka e re": Çfarë kërkon LDK-ja në këmbim të postit të kryeparlamentarit?

Bahtiri: Pasi kemi rifilluar bisedimet, ata këmbëngulin që t'u kthehet posti i kryeparlamentarit. Mendoj se ata duhet ta kuptojnë se kjo çështje tashmë ka përfunduar. Kjo kërkesë nuk është në rregull, sepse t'i humbësh zgjedhjet dhe ta kërkes postin e kryeparlamentarit nuk është e drejtë. Po ashtu, ta kërkes postin e presidentit duke mos përmendur asnjë emër, as kjo nuk është në rregull. Tani bisedimet kanë mbetur te posti i kryeparlamentarit.

"Epoka e re": Po LV-ja, çfarë i ka ofruar LDK-së për postin e kryeparlamentarit?

Bahtiri: Si anëtar i LV-së kam propozuar që si kompensim për postin e kryetarit të Kuvendit t'i jepet LDK-së Ministria e Punëve të Jashtme, ndërsa kur të zgjedhet presidenti në vitin 2021, MPJ-ja t'i kthehet LV-së dhe ta vazhdojmë qeverisjen me nga pesë ministri. Sepse, siç dihet, ata kanë deklaruar se pasi të zgjedhet presidenti i vendit nga LDK-ja, kjo parti një ministri do t'ia japë LV-së. Ne tani po themi se atë ministri ta bëjmë kompromis me postin e kryeparlamentarit. Ky ka qenë një propozim imi që ua kam propozuar LDK-së dhe LV-së. Po ashtu, ju e dini se ministrinë më të fuqishme që i ka qeveria i ka marrë LDK-ja.

"Epoka e re": Cila ka qenë përgjigjja e LDK-së për këtë ofertë?

Bahtiri: Ende nuk na kanë dërguar ndonjë njoftim. Ata kërkojnë që t'u kthehet posti i kryeparlamentarit. Por ky post nuk mund të kthehet, sepse kjo

nuk është lojë e fëmijëve. Kryetari i ri i Kuvendit është zgjedhur në mënyrë demokratike. Z. Konjufca është kryetari më i mirë që ka pasur ndonjëherë Kuvendi i Kosovës. LDK-ja duhet ta dijë se nuk kemi kohë për të humbur për ta çuar në vend vullnetin e qytetarëve të shprehur me votën e lirë në zgjedhjet e 6 tetorit. Dihet se qeverinë e re e presin sfida të rëndësishme si dialogu me Serbinë, zhvillimi ekonomik dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në këtë situatë neve na ka humbur edhe besimi, sepse fillimisht të votosh pro kryeparlamentarit dhe pas tri jave të kërkosh ta shkarkosh është e pamoralshme dhe jonjerëzore.

"Epoka e re": Por si fituese e zgjedhjeve LV-së i takon që ta zhblokojë situatën.

Bahtiri: Neve nuk na ka mbetur gjë tjetër vetëm t'ia japim një fletë të bardhë dhe një stilolaps Isa Mustafës dhe ai të shkruajë çfarë të dojë. Pastaj ne të shohim se çfarë ka shkruar, sepse ende nuk po e dimë se çfarë po dëshiron konkretisht. Kjo zvarritje e mosrealizimit të vullnetit qytetar për të qeverisur së bashku është e pakuptimtë. Natyrisht se këtë zvarritje e ndien secili qytetar. Nuk e di se si ia ka vënë syrin Isa Mustafa këtij procesi, por kjo nuk është në parimet demokratike dhe nuk është as në vullnetin e deputetëve dhe të elektoratit të LDK-së.

"Epoka e re": Çka nëse nuk arrihet një marrëveshje me LDK-në, a ka plan 'B' LV-ja?

Bahtiri: Mendoj se ne do t'i presim edhe pak. Pastaj do të thirrret Këshilli i Përgjithshëm i LV-së dhe do të ecim përpara. Nuk e di cila do të jetë zgjidhja, por e di se Republika e Kosovës nuk mund të jetë në bllokadë. Këtë bllokadë është duke e bërë Isa Mustafa.

"Epoka e re": A mund të shikojë Vetëvendosja edhe partner tjetër për ta formuar qeverinë e re?

Bahtiri: Në fund do të marrë vendim Këshilli i Përgjithshëm i LV-së dhe atë vendim ju si media sigurisht se do ta shihni. Ne nuk dëshirojmë që ta bllokojmë shtetin dhe nuk do ta bëjmë një gjë të tillë. Ne do të presim edhe pak, por jo shumë. Ne kemi bërë maksimumin nga vullneti ynë i mirë që të bashkëqeverisim dhe ta çojmë vendin përpara. Kushdo që dëshiron ndryshe, besoj se do të përballet me qytetarët e Kosovës dhe simpatizantët e tyre.

"Epoka e re": Sa do ta prisni LDK-në, një javë apo më shumë?

Bahtiri: Mendoj se shumë pak kohë ka mbetur. Qytetarët janë të zhgënjyer nga qëndrimet e Isa Mustafës. Ne jemi të interesuar të vazhdojmë përpara, por jo me këto bllokada dhe inate.



Haradinaj jep dorëheqje edhe nga posti i kryetarit të AAK-së

PRISHTINË, 12 JANAR - Muaj më parë dha dorëheqje nga kryetari i qeverisë. Ramush Haradinaj dorëheqje ka dhënë edhe nga kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Këtë veprim thotë ta ketë ndërmarrë për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të brendshme partiake dhe se deri në kuvendin e ri të AAK-së do të jetë vetëm

ushtrues detyre i kryetarit. "Jam i dorëhequr. Do të thotë, prej kuvendit të fundit të punës që e mbajtëm jam i dorëhequr. Kryej vetëm funksionet në dorëheqje që i kemi deri në zgjedhje", thotë ai për "Ekonomia Online". Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës më 29 dhjetor të vitit që lamë pas shpalli zgjedhjet e reja të brendshme.



Apostolova vlerëson përkushtimin e KFOR-it në ruajtjen e sigurisë në rajon

PRISHTINË, 12 JANAR - Shefja e BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ka vizituar bazën e KFOR-it në Kosovë, ku është pritur nga Michele Risi, komandant i KFOR-it. Në komunikatën e lëshuar për media është bërë me dije se Apostolova ka vlerësuar lart bashkëpunimin me KFOR-in si forcë shumë e rëndësishme e sigurisë. Më tej në komunikatë thuhet se Apostolova ka vlerë-

suar përkushtimin e KFOR-it për ruajtjen e sigurisë së përgjithshme në rajon e që, sipas saj, është parakushti për rifillimin e dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Ndërkaq, komandanti i KFOR-it ka shprehur përkushtimin e tij për planifikimin dhe implementimin e projekteve që janë në të mirë të të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Deli Balidemaj garon për Këshillin e qytetit të Munihut

PRISHTINË, 12 JANAR - Deli Balidemaj ka lindur më 27 korrik të vitit 1967 në Martinaj, Komuna e Plavës. Balidemaj aspiron dhe dëshiron të jetë një shembull për brezat e rinj. Ai dëshiron t'i inkurajojë brezat e rinj se politika është jo vetëm reale, por edhe e arritshme. Balidemaj vjen nga Partia e Gjellbër Die Grünen, e cila në vitet e fundit ka bërë ngritje të vazhdueshme. "Epoka e re" ka realizuar një intervistë me ing. dipl. Deli Balidemaj, deputet në Parlamentin e Bavarisë së Epërme, i cili këtë herë do të kandidojë për Këshillin e qytetit të Munihut në zgjedhjet që do të mbahen më 15 mars.

"Epoka e re": Z. Balidemaj, ju jeni deputet dhe keni kandiduar edhe për Këshillin e qytetit të Munihut. Çfarë ju shtyri për një hap të tillë?

Balidemaj: Ky është një nder dhe detyrë e madhe për mua. Të jesh këshilltar i qytetit të Munihut është një përgjegjësi, nder dhe krenari e papërshkruar. Qyteti i Munihut ka përafërsisht 1.6 milion banor dhe ka një Këshill prej 80 këshilltarëve. Në Muniht jetojnë 180 nacionalitete dhe fliten 200 gjuhë. Të jesh pjesë e vendimmarrjes në qytetin ku jeton me familje dhe shoqëri

është për mua diçka e veçantë dhe shumë bujare.

"Epoka e re": Me cilat tema jeni duke bërë fushatën zgjedhore?

Balidemaj: Në fushatën zgjedhore tema kryesore kam diversitetin në shoqëri, arsimin dhe digjitalizimin, arsim më inovativ dhe efektiv, të drejtat e barabarta në arsim dhe punësim për të gjithë, garantimin e të drejtave të personave të hendikepuar, komunikacionin urban dhe ndërrurban, mbrojtjen e mjedisit, integrimin më të mirë dhe cilësor të të huajve në shoqërinë gjermane. Ajo që sot shqetëson njerëzit në Gjermani dhe Evropë është se flitet shumë për urrejtje, ka një shtim të gjuhës së urrejtjes. Ne të gjelbrit dhe unë posaçërisht nuk fokusohem te kjo. Sigurisht që ka sfida që duhet t'i trajtojmë me guxim, por ne duhet të ofrojmë zgjidhje dhe ide të zgjuara, jo gjithmonë me ankesa, ngaqë aq keq edhe nuk janë punët.

"Epoka e re": Ju jeni edhe përgjegjës për integrime. Ku është kufiri mes integritit dhe asimilimit?

Balidemaj: Të integrohesh është të kesh jetë më të mirë dhe të jesh pjesë aktive e shoqërisë. Këtu ka çdo qytetar të drejtën e



pjesëmarrjes, varet nga individit sa merr pjesë në proceset shoqërore dhe çfarë përfitimesh ka. Integrimi/pjesëmarrja nuk do të thotë se duhet të harrohet vendlindja! Përkundrazi, këtë gjë duhet ta kuptojnë dhe ta kenë gjithmonë parasysh

bashkëkombësit e mi. Sa më të integruar shoqërisht dhe profesionalisht aq më shumë ka mundësi të ndihmohet vendi i lindjes. Neve nuk duhet dhe nuk mund ta mohojmë kurrë prejardhjen tonë. Shqiptarët dhe të huajt e tjerë që jetojnë jashtë vendit dhe janë aktivë në politikë dhe në fushat e tjera mund të sjellin vetëm gjëra pozitive si eksperiencia dhe kultura të reja pune për vendet e prejardhjes me një përkushtim dhe punë të madhe. Së pari, krijohen marrëdhënie mes njerëzve dhe shteteve dhe, së dyti, fitohen njohuri dhe pikëpamje nga një këndvështrim tjetër se si funksionon Gjermania dhe politika gjermane.

"Epoka e re": Si e shihni politikën e Kosovës dhe sa keni bashkëpunim me Konsullatat në Muniht?

Balidemaj: Politika e Kosovës është rrënjësore thellë në strukturat ekzistuese apo të trashëguara dhe nuk mund ose nuk ka vullnet të shohë jashtë "rrethit të vet". Ajo është në një gjendje kolapsi. Kohë të gjatë janë bërë gabime të njëpasnjëshme dhe tani, nëse tentohet të ndryshohen ato praktika dhe të futen standarde të reja, është thujtë e pamundur. Të gjithë ankohen se diçka nuk po funksionon por, në anën tjetër, nuk përkrahen ndryshimet pozitive. Mjafton të dëgjosh gjithë ata analistë dhe menjëherë ke kokëdhimbje. E tmerrshme, po e mbajnë një popull në ankth. Sa i përket bashkëpunimit me konsullatat, nuk kam bashkëpunim ngaqë nuk kemi gjetur gjuhë të përbashkët.

"Epoka e re": Para disa ditësh u keni dërguar një letër elektron-

ike shumë komuniteteve në Muniht me dëshirë për t'u takuar dhe biseduar për tema të ndryshme?

Balidemaj: Po, deri tani së bashku me kandidaten për kryebashkiake, z. Habenschaden, kemi pasur takim me komunitetin turk, javën që vjen kemi takim me komunitetin kroat dhe jemi në koordinim për takim me komunitetin italian, rumun dhe të Bosnjës.

"Epoka e re": Ju jeni shumë aktiv dhe i angazhuar për përfshirjen dhe integrimin e bashkatdhetarëve në Bavari. Cili është mesazhi juaj për bashkatdhetarët?

Balidemaj: Çdoherë i gatshëm për të biseduar rreth mundësive dhe ideve të reja të cilat do ta avancojnë pozitën e bashkatdhetarëve në Muniht/Bavari. Pres, gjithashtu, reagime, propozime si dhe kritika nga të gjithë bashkëkombësit. Arsimimi, puna e ndershme, respekti dhe, mbi të gjitha, familja e ngritur, janë themelet për një të ardhme të ndritur. Çdo shqiptar që jeton në Gjermani duhet të ketë parasysh që ai nuk prezanton vetëm veten, por edhe vendin nga ka ardhur. Mendimet e ndryshme nuk duhen parë negativisht pasi na bëjnë të reflektojmë. Vetëm të bashkuar do të mund t'i arrijmë qëllimet madhore. I ftoj të gjithë qytetarët e Munihut me të drejtë vote, posaçërisht bashkëkombësit, të më përkrahin me votën e tyre. Unë nuk premtoj mrekulli, por premtoj se do të angazhohem maksimalisht për aq sa kam mundësi dhe hapësirë, për temat dhe projektet që do t'i kemi përpara. Ju falënderoj përzemërsisht për mundësinë e dhënë!




Rreth 28 mijë dhurues vullnetarë të gjakut në Kosovë

PRISHTINË, 12 JANAR - Rreth 90 për qind të nevojave të pacientëve për gjak, në institucione publike shëndetësore në Kosovë, sigurohet nga dhuruesit vullnetarë të gjakut. Këto informacione i konfirmon drejtoresha e Transfuzionit të Gjakut, Bukurie Raca, e cila tha për "Radion Evropa e Lirë" se gjatë vitit të kaluar (2019) vetëm nga dhuruesit vullnetarë janë siguruar rreth 28 mijë doza gjak. Kurse pjesa tjetër, tha ajo, mbulohet nga familjarët, kryesisht për grupet e gjakut që janë më të rralla. "Mund të them se ka qenë një vit me një sasi që ka arritur t'i mbulojë kërkesat e gjakut dhe produkteve të gjakut që kanë pasur nevojë. Gjatë vitit të kaluar kemi pasur një rrjedhë pozitive të dhurimit të gjakut dhe janë dhuruar 28 mijë doza. Pra, 87 për qind kemi dhurim vullnetar të gjakut, kurse pjesa tjetër ka mbetur të mbulohet nga familjarët", ka thënë Raca.

Raca, gjithashtu, ka shtuar se, pavarësisht se ku trajtohen pacientët, në institucion publik ose privat, kanë të drejtë të kenë qasje në doza të gjakut. Në bazë të një udhëzimi administrativ, spitalet private janë të obliguara të bëjnë marrëveshje me

Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe të marrin gjak në rast nevojë për ndonjë pacient. "Institucionet private porsa hapen janë të obliguara me ligj të bëjnë marrëveshje me Transfuzionin e Gjakut dhe asnjë pacient, në rast nevojë, nuk mund të mbetet pa sasinë e nevojshme të gjakut, pasi është e drejtë e tyre, pavarësisht se ku vendosin të trajtohen", ka thënë Raca.

Një nga klinikat që ka nevojë të vazhdueshme për gjak është ajo e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës. Drejtori i kësaj klinike, Jakup Ismaili, ka thënë se vetëm për një natë kujdestarie ndodh të kërkohej në transfuzion deri në 20 doza gjak, kryesisht për rastet e lindjeve me prerje cezariene. "Tek ne në klinikë kërkohej shumë doza gjaku. Asnjëherë asnjë pacient nuk ka pasur problem në këtë klinikë që të sigurohet gjaku i nevojshëm për pacientet. Edhe nëse kërkohej shumë gjak, ai sigurohet. Ne asnjëherë nuk mendojmë në atë aspekt se ndonjë pacient mund të pësojë për mungesë gjaku. Pra, në këtë pikë jemi mirë, por duhet ta cek, po ashtu, se klinika jonë është më specifike dhe gjithmonë ka pasur përparësi për sig-



urimin e dozave të gjakut", është shprehur Ismaili.

Edhe në Qendrën Emergjente, ku fluksi i pacientëve është i madh, drejtori Basri Lenjani ka thënë se që nga viti 1999 nga Qendra e Transfuzionit të Gjakut janë mbuluar 100 për qind me dozat e nevojshme të gjakut të gjithë pacientët që kanë pasur nevojë. Qytetarët e shohin si shumë humane dhe jetëshpëtuese dhurimin vullnetar të gjakut.

Kastriot Vishaj nga Prishtina

thotë se është dhurues vullnetar i gjakut dhe se ai dhuron disa herë brenda vitit. Si kompensim, ai thotë se ka marrë kartelën nga Transfuzioni i Gjakut, që në rast nevojë për të ose familjarët e tij, ata gjithmonë do të kenë përparësi të marrin, përkatësisht t'i sigurojnë dozat e gjakut. "Sa të jem mirë më shëndet unë do të dhuroj gjak për njerëzit që kanë nevojë dhe ndoshta edhe shpëtoj jetë, por nëse ndonjëherë do të kem nevojë unë të marr gjak, e di

se do të kem përparësi, pasi me vite të tëra dhuroj vullnetarisht gjak dhe tashmë e kam edhe kartelën që vetë institucioni ma ka dhënë mua dhe gjithë vullnetarëve, dhurues të gjakut", ka thënë ai.

Bazuar në të dhënat e Transfuzionit të Gjakut, numri i dhuruesve të gjakut në Kosovë po rritet nga viti në vit. Dhuruesit e gjakut janë të moshave të ndryshme dhe grupeve të ndryshme të gjakut.

Sot fillon gjysmëvjetori i dytë



EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 JANAR - Sot (e hënë) do të rinisë mësimi në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës. Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Republikës së Kosovës (SBASHK) përmes një komunikate për media ka njoftuar se mësimi do të nisë në të gjitha

shkollat, duke mohuar çdo lajm që bëhet thirrje për grevë. "Këtyre ditëve në selinë e SBASHK-ut kemi marrë shumë telefonata nga individë, por edhe nga disa medie të nderuara e që kanë të bëjnë me gjysmëvjetorin e dytë, për t'i hequr shqetësimet e prindërve dhe për t'ua pamundësuar individëve të caktuar, që me apo pa dashje të shpërndajnë dezinformata,

SBASHK-u u drejtohet të punësuarve në arsimin parauniversitar dhe nxënësve të nderuar me urimin për rifillim të mbarë të betejës për dije të reja. Pra, më 13 janar do të rinisë mësimi në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës dhe SBASHK-u pret që të përmbillet në tërësi aktiviteti i nisur nga anëtarësia për mbledhjen e nënshkrimeve dhe dërgimin e kërkesave në

Qeverinë e Kosovës dhe tek institucioni i Avokatit të Popullit, me kërkesën që ata t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për revokimin e vendimit të masës së përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut. Këshilli Drejtues, kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të universiteteve, bashkë me kryesinë e SBASHK-ut, kanë

uruar që sa më parë ta fillojnë punën institucionet e dala nga vota e 6 tetorit dhe të rinisë dialogu për shumë çështje në arsim. "SBASHK-u vepron në bazë të zërit të punëtorëve në tërë arsimin e Kosovës dhe sa herë që anëtarësia vlerëson se dialogu nuk po jep rezultate të duhura, atëherë fillohet me veprime sindikale", është theksuar në komunikatën e SBASHK-ut.

Bizneset nuk preferojnë arbitrazhin

PRISHTINË, 12 JANAR - Zgjidhja e një kontesti ekonomik mes bizneseve në gjykatat e Kosovës mund të zgjasë me vite të tëra. Ndërkohë në zyrat e arbitrazhit, të cilat funksionojnë në kuadër të odave ekonomike në vend, thuhet se kontestet mund të zgjidhen brenda një periudhë gjashtëmujore. Por, pavarësisht kësaj, bizneset vazhdojnë të mos iu drejtohen këtyre qendrave të arbitrazhit dhe numri i rasteve që trajtohen nga këto qendra mbetet i ulët.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane (OEAK), Arian Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se që nga funksionimi i qendrës së arbitrazhit në OEAK numri i kontesteve ekonomike të zgjidhura është mbi dhjetë raste që, sipas tij, është i ulët. Ai ka theksuar se bizneset nuk po shfrytëzojnë arbitrazhin për zgjidhjen e kontesteve ekonomike, pavarësisht përfitimeve që mund t'i kenë. "Procedurat për zgjidhjen e kontesteve përmes arbitrazhit janë shumë efikase. Në rastin e një kontesti më kompleks, ato nuk zgjasin më shumë se gjashtë muaj dhe të njëjtat aktivime që lëshohen nga tribunalet e arbitrazhit, vetëm konfirmohen nga gjykatat përkatëse të shtetit dhe të njëjtat mund të përmbahen. Aktgjykimet në arbitrazh apelojnë vetëm në aspektin

procedural", është shprehur Zeka.

Kontestet ndër biznesore të cilat paraqiten në Tribunalin e Arbitrazhit në Odën Amerikane, thotë Zeka, janë të natyrave të ndryshme. Kryesisht bëhet fjalë për mosbatim të dispozitave kontraktuale ose keqinterpretim të këtyre dispozitave ndërmjet bizneseve. "Përdorimi i arbitrazhit do ta zvogëlonte edhe numrin e rasteve që shkojnë në gjykatë dhe u nënshtrohen vonesave që bëhen në zgjidhjen e tyre. Prej dy deri tri vjet në njërin prej instancave gjyqësore, mund të zgjasë një zgjidhje e një kontesti ekonomik mes bizneseve", ka thënë Zeka.

Që nga viti 2011 në Kosovë janë hapur disa qendra të arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve biznesore, të cilat mund të shfrytëzohen për t'i shmangur proceset e gjata gjyqësore.

Qendrat e arbitrazhit funksionojnë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Eksperti për çështje financiare, Milazim Abazi, ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se kontestet e shumta ekonomike, lëndët e të cilave presin për vite në gjykatat në Kosovë, do të mund të zvogëloheshin vetëm në rast të krijimit të gjykatës



komerciale. "Një gjë e mirë që ka ndodhur në zgjidhjen e kontesteve është aktivizimi i përmburësve privatë, por ajo nuk është e mjaftueshme për t'i zgjidhur problemet e shumta që janë mes bizneseve. Krahas reformave që duhet të ndërmerren në sistemin gjyqësor, duhet të jetë edhe krijimi i gjykatës komerciale, pasi që

vetëm ajo do të ndihmonte në zgjidhjen e kontesteve të shumta ekonomike mes bizneseve", ka deklaruar Abazi. Krijimin e Gjykatës Komerciale e kishte paralajmëruar ministri i Drejtësisë në detyrë në Qeverinë e Kosovës, Abelard Tahiri. Gjykata Komerciale ishte theksuar të jetë e rëndësishme për Kosovën, pasi ajo

do ta rriste efikasitetin e trajtimit të lëndëve të biznesit dhe do të ndihmonte në krijimin e një ambienti më të mirë për bizneset vendore dhe për investitorët e huaj. Numri i përgjithshëm i lëndëve në gjykatat e regjistruara në Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve është mbi 100 mijë lëndë.

ATK-ja e mbush buxhetin e shtetit me rreth 500 milionë euro

PRISHTINË, 12 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) edhe në vitin 2019 është ballafaquar me vështirësi në inkasimin e borxheve në pjesën veriore të Kosovës. Janë mbledhur 106 milionë euro prej 357 milionë eurosh.

Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka thënë se në vitin 2019 ATK-ja ka shënuar përparim në inkasimin e të hyrave vjetore, ku për periudhën janar-dhjetor ka mbledhur rreth 500 milionë euro. "Inkasimi i të hyrave në Administratën Tatimore është mbi 497 milionë euro, shumë kjo e cila tregon një performancë të shkëlqyer të institucionit të ATK-së. Për herë të parë do të ndodhë tejkalimi i shifrës mbi 500 milionë euro si të hyra në kuadër të buxhetit të Kosovës nga Administrata Tatimore e Kosovës", ka thënë Murtezaj në një intervistë për "KosovaPress".

Ai ka shtuar se gjatë vitit që lamë

pas nuk kanë munguar as sukseset në grumbullimin e borxheve, ku deri tani janë mbledhur gjithsej 106 milionë euro, prej gjithsej 357 milionë eurosh në total sa është borxhi ndaj ATK-së. Murtezaj ka theksuar se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, mbledhja e borxheve është rritur për 40 për qind. E përkundër përpjekjeve që edhe pjesa veriore të trajtohet e barabartë me pjesën tjetër të Kosovës, drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, thotë se kanë vështirësi në mbledhjen e borxheve dhe identifikimin e tatimeve reale në Mitrovicën Veriore.

Edhe në vitin 2019 informaliteti ekonomik ka qenë sfidë për ekonominë e Kosovës, e cila, sipas Murtezajt, në dhjetë vjetët e fundit niveli i informalitetit është 30 për qind. Sipas tij, gjatë këtij viti ATK-ja ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve me qëllim të uljes së këtij niveli të informalitetit në Kosovë.



Vonesat për formimin e qeverisë, nga 1 marsi nuk realizohet asnjë pagesë

PRISHTINË, 12 JANAR - Vonesat për formimin e qeverisë pritet të shkaktojnë probleme buxhetore në vend. Këshilltari politik në Ministrinë e Financave, Lulëzim Rafuna, ka thënë për "Ekonomia Online" se në rast se nuk formohet qeveria e re, më 1 mars nuk do të mund të realizohet asnjë pagesë, përfshirë edhe pagat e punonjësve shtetërorë. Pavarësisht se me ligj nuk përcaktohet ndonjë afat kohor se kur duhet të miratohet buxheti i shtetit, Rafuna thotë se nëse është Kuvendi aktiv afati optimal është 31 tetori. "Sa i përket formimit të qeverisë sa më shpejt që të ketë qeveri është më mirë për vendin dhe për institucionet e vendit, ndërsa nuk ka ndonjë afat ligjor se kur duhet të ketë qeveri. Sa i përket buxhetit të Republikës së Kosovës në Ligjin për menaxhimin e financave publike nuk ka ndonjë afat ligjor se kur duhet të aprovohet buxheti në qeveri. Me përjashtim të rastit kur Ligji për menaxhimin të financave publike e parasheh se në situatat kur e ke një Kuvend të Republikës së Kosovës deri më 31 tetor duhet të aprovohet buxheti, duhet të

shkojë në Kuvend të Republikës së Kosovës. Mirëpo në rastin konkret ne kemi një situatë më ndryshe për arsye se më 31 tetor ne nuk kemi pasur Kuvend për shkak të procesit të zgjedhjeve", ka thënë ai. Rafuna ka pohuar se Ministria e Financave ka përgatitur buxhetin ashtu siç ka qenë i obliguar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe është i gatshëm për procedim në Qeveri e Kuvend. "Ministria e Financave kësaj radhe i ka ndërmarrë të gjithë hapat dhe ka përgatitur buxhetin siç ka qenë e obliguar me ligjin Për menaxhimin e financave publike dhe një draft është final në Ministri të Financave, i cili është i gatshëm që në rrethanat të cilat ndodhemi sot, për arsye se buxheti është përgatitur në rrethana dhe në kohën që jemi tani dhe është i gatshëm që të përcillet tutje për në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike nuk njih ndonjë term me përjashtim të termit qeveri, nuk njih qeveri në dorëheqje, qeveri në detyrë. Gjykata Kushtetuese nuk ia konteston qeverisë e cila është sot në detyrë që të marrë vendime",



ka deklaruar ai. Këshilltari i ish-ministrit të Financave, Bedri Hamza, ka shpjeguar se nga buxheti i vitit 2019 mund të shfrytëzohen vetëm dy muajt e parë të vitit 2020. Ndërsa për muajin mars duhet një vendim i Kuvendit. "Janë dy situata Ligji i Menaxhimit të Financave Publike parasheh se në qoftë se ka pasur zgjedhje katër muaj

sesa që fillon viti fiskal, atëherë muaji i parë dhe i dytë janar dhe shkurt do të implementohet buxheti i vitit 2019 dhe shkon ndarja 1/12 e tutje, në rast se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ndërmer veprime për ta sjellë një vendim që edhe gjatë muajit mars të implementohet buxheti i vitit 2019, kjo nënkupton që më 1 mars asnjë pagesë tjetër nuk mund të

bëhet me përjashtim të borxhit publik ndërkombëtar", ka thënë ai.

Por në qoftë se nuk kemi Qeveri dhe Kuvendi nuk nxjerrë një vendim, Rafuna thotë se më 1 mars nuk do të mund të realizohet asnjë pagesë, me përjashtim të borxhit publik ndërkombëtar. "Në rast se Kuvendi i Republikës së Kosovës e sjell një vendim që e mbulon implementimin e buxhetit të vitit 2019 atëherë nënkupton që më 1 prill asnjë pagesë nuk mund të bëhet, me përjashtim të borxhit publik ndërkombëtar. I kemi dy situata. Situata e parë kur nuk sjell vendim, atëherë çdo gjë ndërpritet më 1 mars dhe situatën e dytë e kemi në rast se Kuvendi sjell vendim për muajin mars, gjithçka ndërpritet më 1 prill dhe çdo pagesë brenda nuk mund të bëhet me përjashtim të borxhit publik ndërkombëtar", është shprehur Rafuna. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u mbajtën më 6 tetor dhe nga atëherë Kosova ka mbetur pa institucione për shkak të neglizhencës së partisë fituese e cila nuk po gjen formulë për sigurimin e shumicës parlamentare për formimin e qeverisë.

Mbi 18 000 biznese të reja u regjistruan në Shqipëri në 2019-n

TIRANË, 12 JANAR - Mbi 18 000 biznese të reja janë regjistruar në Shqipëri në vitin 2019. Këtë e ka bërë me dije drejtoresha e përgjithshme e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), Pranvera Fagu, në një prononcim për ATSh-në, duke shtuar se trendi i rritjes së numrit të bizneseve të reja të regjistruara në Shqipëri është afërsisht i njëjtë me vitet paraardhëse. Qeveria thotë se përmirësimi i mëtejshëm i terrenit ekonomik dhe klimës së biznesit është sfida që vazhdon në fazën e dytë të programit ekonomik të saj. Ajo ka marrë përsipër të zhvillojë disa iniciativa që lidhen me zonat ekonomike dhe teknologjike, që janë zona ku vetë qeveria merr përsipër ta lehtësojë biznesin jo vetëm në aspektin procedural, por edhe tarifor, doganor, ose të pagesës së taksave. Gjatë viteve të fundit Qeveria e Shqipërisë ka përmirësuar ligjin e Partneritetit Publik Privat, ka hartuar një ligj të ri të inves-

timeve strategjike, ka mundësuar një ligj të ri të turizmit, si dhe i ka dhënë një dimension të ri AIDA-s, duke e kthyer në portalin e vetëm unik ku mund të shkojë biznesi dhe të jetë investitor dhe Agjencia të marrë përsipër ta asistojë atë me procedura të lehtësuara e të veçanta. Më 1 janar të këtij viti ka shënuar fillimin e revolucionit digjital edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Është një proces që do të rrisë, pa dyshim, thjeshtimin e shërbimeve ndaj publikut. Do t'i ulë radhët dhe t'i eliminojë burokracitë administrative, kursim kohe dhe kursim kostosh financiare. Tashmë bizneset do të ndihen të lehtësuara për kryerjen e aplikimeve për dokumentet që më parë duhet t'i merrnin në zyrat e shtetit. Sot të gjitha dokumentet shoqëruese që lëshohen nga institucionet shtetërore do të sigurohen nga vetë administrata. Ky proces do të ofrojë shërbime publike shumë më efektive e më cilësore.



Gjashtë vjet nga firmosja e deklaratës për bashkëpunim dhe partneritet strategjik të Kosovës dhe Shqipërisë



Sylë UKSHINI

Më 11 janar u mbushën 6 vjet nga mbledhja e parë ndërmjet dy qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë, e cila jetëson vullnetin, aspiratën dhe angazhimin e shumë brezave për realizimin e projekteve të përbashkëta me karakter strategjik dhe afatgjatë. Ky takim shënon një kapitull të ri në historinë e dy shteteve ngaqë për herë të parë në Prizren u firmosë Deklarata për Bashkëpunim dhe Partneritet

Strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Kjo marrëveshje konsiston në këto shtylla kryesore: Politika e Jashtme dhe e Sigurisë; Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme; Ekonomia, Energjia, Transporti, Turizmi dhe Mbrojtja dhe Mjedisit; Kultura, Arsimit dhe Shkenca. Ky partneritet strategjik, i themeluar gjashtë vjet më parë, tejkalon mandatet e qeverive në Prishtinë dhe në Tiranë dhe përbën një partneritet strategjik afatgjatë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Duhet shtuar se ky dokument ishte vazhdimësi e Protokollit të Bashkëpunimit Ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë i nënshkruar më 15 mars 2013, në Tiranë, që ravigëzon objektivat e një bashkëpunimi dypalësh, të intensifikuar dhe shumëdimensional. Po ashtu, ky protokoll i

përgatitur nga ekipet e MPJ-së së Kosovës dhe të Shqipërisë mbulon fushat kryesore të bashkëpunimit dypalësh, por nuk mbulon dispozitat ligjore përkatëse, burimet financiare dhe mbështetjen administrative. Isha i privilegjuar që së bashku me disa specialistë të kabineteve të MPJ-së në Prishtinë dhe në Tiranë të jem pjesë e grupit punues për përgatitjen, sinkronizimin dhe harmonizimin e propozimeve të Protokollit dhe të Deklaratës për Bashkëpunim Strategjik dhe i gjithë agjendës së takimit historik të Prizrenit. Në këtë kuptim, me aktin e nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik nga të dy qeverive u materializua angazhimi i ndërsjellë dhe afatgjatë për shndërrimin e marrëdhënies tona bilaterale në një

model të ri, në përputhje me praktikën e konsoliduar në rajon dhe më gjerë.

Po ashtu, mendoj se, krahas bilancit të mbledhjeve të deritanishme, është koha për ndryshimin e formatit të takimeve të tilla, në vend të mbledhjeve sa për efekt mediatik, duhet të ketë takime me sa më shumë përmbajtje, ku do të identifikoheshin sektorët strategjikë dhe do të merreshin vendime të duhura për evitimin e të gjitha barrierave dhe burokracive që frenojnë jetësimin e vullnetit politik nga të dyja anët. Mbi të gjitha, në këtë moment të rëndësishëm për Kosovën, kur Beogradi vazhdon agresionin politik dhe diplomatik ndaj Republikës së Kosovës, dhe gjithnjë duke iu referuar dokumentit për partneritet strategjik, dy vendet tona duhet ta thellojnë

bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme, si dhe koordinimin më efikas dhe proaktiv në funksion të koordinimit të përpjekjeve dhe aksionit diplomatik për afirmimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të identitetit shtetëror dhe pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përmes shtimit të numrit të njohjeve, anëtarësimit në organizatat rajonale, evropiane e globale, si dhe integritet të plotë të saj në sistemin ndërkombëtar, me synimin final anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Partneriteti strategjik Kosovë - Shqipëri synon të jetë model për rajonin dhe një prioritet i integritet evropian, si instrumenti më efektiv për stabilitetin, paqen dhe progresin dhe mirëqenien e rajonit.

Ndezja e flakadanëve shënon hapjen e manifestimit 'Flaka e Janarit 2020'

GJILAN, 12 JANAR (ER) - Me ndezjen e flakadanëve në ballkonin e Teatrit të Qytetit, te shtatoret e heronjve Rexhep Mala e Nuhi Berisha dhe te varrezat e dëshmorëve, në Gjilan zyrtarisht ka nisur manifestimi kulturor mbarëkombëtar "Flaka e Janarit 2020", që është i 29-ti me radhë, nëpërmjet të cilit me vlera të mirëfillta kulturore nderohet jeta dhe vepra e të rënëve për liri. Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Shpresa Kurteshi, ka theksuar se me këtë manifestim nderohen të gjithë ata që dhanë kontribut për liri që nga epoka e lavdishme e Skënderbeut e deri te periudha më e re e Kosovës. "Ky vit do të jetë më i veçantë. Edhe kësaj radhe 'Flaka e

Janarit' do të vijë me aktivitete të ndryshme kulturore, duke u mbështetur në katër shtyllat e saj: letërsi, muzikë, art pamor dhe art dramatik. Ju ftoj që t'i përcillni aktivitetet që zgjasin deri më 31 janar", ka thënë Kurteshi Emini. Ndërsa Deniza Limani, drejtoreshë për Kulturë, Rini e Sport në Gjilan, ka thënë se për të është nder për të që merr pjesë në ndezjen e flakadanit të "Flakës së Janarit". Ajo ka thënë se ta gjitha aktivitetet e flakës do të bëhen për nder të heronjve dhe të rënëve për liri. Në anën tjetër, në emër të familjes Mala dhe Berisha, ka folur përfaqësuesi i këtyre familjeve, Bajram Berisha, i cili, pasi i ka përshëndetur të pranishmit, ka kërkuar që asnjëherë



të mos harrohet gjaku i të rënëve për liri. Më pas është bërë ndezja zyrtare e flakadanit të "Flaka e

Janarit", të cilën e kanë bërë Shpresa Kurteshi, kryesuese e Asamblesë Komonale të Gjilanit, Deniza Limani, drej-

toreshë për Kulturë, Rini e Sport, Fitore Mala dhe pjesëtarë të familjes Berisha. Ndezja e flakadanit është bërë edhe para shtatoret së Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës në qendër të qytetit, kurse karvani më pas është ngjitur në "Kodrinë e Dëshmorëve", te Varrezat e Dëshmorëve, ku edhe atje flakadani do të mbetet i ndezur deri më 31 janar, kohë kur përmbillet manifestimi kulturor "Flaka e Janarit 2020". Aktiviteti i radhës në "Flakën e Janarit 2020" do të jetë "Akademia e Flakës" më 17 janar në orën 16:00, në Teatrin e Qytetit në Gjilan, ndërkaj në orën 17:30 në Galerinë e Arteve do të hapet ekspozita kolektive dhe do të jepen çmimet në kuadër të "Penelit të Flakës".

80 të rinj gjilanas certifikohen për ndërmarrësi dhe lidërsip


GJILAN, 12 JANAR (ER) - Janë shpërndarë 80 certifikata për të rinjtë e Gjilanit, të cilët kanë ndjekur trajnimet në fushën e ndërmarrësisë, hartimin e projekteve, planeve të biznesit dhe lidërsipit, të cilët janë financuar nga Qeveria e Turqisë. Përkritazi me këtë, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim koordinatorin për Kulturë në Ministrinë e Kulturës në Turqisë, Nedim Asllan, ka thënë se ky ka qenë një projekt shumë i suksesshëm i cili tashmë është zbatuar. "Sot e kemi një përfundim të një projekti të suk-

sesshëm mes dy shteteve tona, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë. Departamenti për Diasporë Turke, vëllezërve tanë në Gjilan iu kemi mundësuar të rinjve të kësaj komune që të ndjekin trajnimet për ndërmarrësi dhe hartimin e projekteve. Me organizatën Liza e kemi realizuar projektin në përpikëri", ka thënë Asllan. Ai është zotuar se edhe në të ardhmen si Qeveri e Turqisë do t'i përkrahin të rinjtë e Gjilanit.

deruar shtetin turk për mundësinë që ua ka dhënë të rinjve të Gjilanit për ndjekjen e këtyre trajnimeve, duke shtuar se kjo do të jetë një mundësi e mirë për hapjen e bizneseve të reja. Ndërsa koordinatori për Kulturë në Ministrinë e Kulturës në Turqisë, Nedim Asllan, ka thënë se ky ka qenë një projekt shumë i suksesshëm i cili tashmë është zbatuar. "Sot e kemi një përfundim të një projekti të suk-



Deri kur do ta mbajë Shqipëria në kurriz këtë klasë parapolitike?



Nga Bedri ISLAMI

Nuk besoj se ka diku tjetër një klasë politike më të vjetër, më hipokrite, zhvatëse dhe pjesë e oligarkisë financiare, si kjo në vendin tonë.

Në 30 vjet pluralizëm kjo klasë politike u kalcifikua, u rrënjos dhe është vetëshpallur babalare e kombit kur, në fakt, janë rrëmihësit e jetës së tij.

Një tabor politik, që u është veshur partive të mëdha, për të qenë pjesë e politikës, pra e zhvatjes dhe për të dërdëllitur nëpër ekranet TV, sikur ata dhe vetëm ata, janë më të diturit, më të ndershmit, më të aftët...

Në fakt, më shumë se nga kushdo tjetër, prej tyre vjen e keqja e këtij vendi. Ata ishin diktatura mbi demokracinë dhe mbetën të tillë.

Kjo klasë politike kërkon me ngulm të njëjtin sistem zgjedhor, listat e mbyllura, vendet e tyre të sigurta në parlament, ku gjithnjë kanë qenë bisht i dikujt dhe lehës ndaj dikujt tjetër.

Pallavat e tempujve të mykur të partive kanë bërë që të ngrihen resorte përrallash në vendet më të hijshme të vendit, të krijohen blloqe parajsore dhe të gjitha përmes vjedhjeve, përvetësimit dhe jo pak herë krimit.

Klasa e tashme politike, ndërsa luan ditën lojën e luftës, në darkë shtriqet në të njëjtin shtrat politik sepse përmes këtij shtrati pa divorc janë të gjitha: pushteti i Njëshit, që zgjedh me dorën e tij deputetët që do ai dhe që paguajnë për të qenë

deputetë, që largon mendjen dhe afron krimin, që i shpall të huaj akademikët dhe i pranon oligarkët.

Një sistem zgjedhor që, qoftë përmes listave të mbyllura apo të hapura (shikoni rastin e Kosovës) oligarku, i forti, beniamini i shefit do të lulëzojë, sepse tashmë krimi është bërë i pranishëm... ai ka fituar pushtetin e pestë, të padiskutueshmin, atë të parasë...

Kur do ta ketë Shqipëria klasën politike që meriton?

Askush nuk e di! Në fakt, ne kemi aktualisht një klasë parapolitike, të deformuar dhe pak të dinjitetshme.

Nuk është një fenomen i ri. Është ripërsëritje e asaj që ka shkuar dhe që, nesër, mund të jetë përsëri.

Në 108 vjet shtet të pavarur ajo që i ka munguar më së shumti këtij vendi ka qenë klasa politike e lidhur me fatin e tij.

Ka ndodhur në qeverinë e parë të Ismail Qemalit, duke tejshkuar të gjitha dhe po ndodh tani në qeverinë e dytë të Edi Ramës. Asnjëra prej tyre, në këto 30 vjet, nuk ka qenë më e rrezikshme dhe fatkobe sesa qeverisjet e Berishës, por kjo nuk është alibi për të tjerat!

30 vjet pluralizëm treguan se edhe në sistemin e tashëm, ashtu si monarki, në republikë parlamentare, në republikë presidenciale, në protektorat, në qeveri kuislinge, nën regjencë, në diktaturë të proletariatit, mungesa më e madhe është klasa politike.

Është vuajtur gjithnjë për një klasë politike dhe elitare, të frymëzuar nga besimi, ndaj së cilës, as oborri monarkik, as i regjencës, as i dualizmit, as i Republikës, as i tashëm, të kishte ndikim mbi ta.

Gjithnjë në kërkim të një klase politike dhe qeverisje të urtë, që

nuk influencohen as nga joshjet, as nga frikësimet, as nga terratitë, por që të ushtronin me kryelartësi privilegjin për të krijuar dhe miratuar ligje të drejta dhe të zbatueshme, që kritikonin pushtetin qeverisës dhe ku, pasi kishin thënë mendimin e tyre pa frikë dhe guximshëm për çka ndodh në shtet, pavarësisht se kush i ka deleguar, ushtrojnë të drejtën e tyre për t'i kontrolluar shtetarët e lartë dhe për t'u larguar ato.

Në tridhjetë vjet pluralizëm, më shumë se mend dhe rrugështrirje vizionesh kemi dëgjuar sharje, mallkime, lëpirje, kurrizulje, bastisje, denigrime.

Po të ishin të vërteta ato që ka thënë Berisha për Ilir Metën, ky i fundit nuk do të kishte dalë kurrë nga burgjet e rena!

Po të ishin të vërteta ato që ka thënë Berisha për Ramën, ky i fundit do të ishte në fillimin e burgimit të tij pafund!

Nëse do të ishin të vërteta çfarë ka thënë Meta për Berishën dhe familjen e tij, e gjithë familja ish-kryeministore do të ishte, ose në arrati, ose në një lëmsh burgu që nuk do të merrej vesh! Nëse do të ishin të vërteta se çfarë ka thënë Rama për Berishën, familjen e tij dhe njerëzit rreth tij, ajo familje nuk do të ishte askund!

E njëjta gjë ka ndodhur në "duelin" Berisha-Nano, Rama-Meta, Meta-Basha, Majko-Berisha, Nano-Berisha, Pollo-Berisha, Ceka-Berisha, Kryemadhi-Rama, Vasili-Basha, një lëvizje uliksiane e pafund! Ndoshta të gjitha ishin të vërteta dhe duhet saktësuar se shumë prej tyre ishin të vërteta! Pasuria marramendëse dëshmon se e vërteta ishte hapur e dukshme, por ndëshkimi frikshëm i fshehur!

Klasa politike u pasurua, u zvetënua, hodhi poshtë çdo mirësi, çdo vizion të së

ardhmes, çdo trashëgimi të së shkuarës.

Të njëjtët që ngritën monumentet e heronjve të luftës, po ngritën tani monumentet e vrasësve të tyre! Ata që në dhjetor 1990 bënë hapin e parë të lirisë, tani nuk janë. Nga 338 themelues të PD-së, në strukturë ka mbetur vetëm një sundues i tyre, Berisha. Thuajse të gjithë pjesët e kryesisë së PD-së së tashmë vijnë nga familje të regjura komuniste, ndërkohë që duan t'i nxjerrin sytë e parlamentarëve anash tyre për të njëjtën gjë!

Skalioni i dytë komunist bëri "demokratizimin" e vendit dhe ngritën në pedestal Hijen e sunduesit.

Sa ishin në një stan dhe ose synonin të bëheshin të një stani, ia kanë fërkuar plagët njëri-tjetrit, i kanë shkuar për dreka e darka në prag të gjyqeve, i kanë lëpirë fjalët e tyre, rasti Berisha-Nano dhe Berisha-Meta; Rama-Meta dhe Pollo-Berisha; e sapo janë ndarë i janë vërsulur qenërisht njëri-tjetrit, për t'u bashkuar rishtas nën një sinjal të ri pushteti!

Njoh figura të pastra pushtetare, që kanë qenë zëvendëskryeministra, ministra, drejtues institucionesh të rëndësishme, që tani jetojnë si gjithë të tjerët, pinë kafenë e lirë, bisedojnë për libra dhe shkencë, por që pasardhësit e tyre i quajnë të pazotë, të aftë, të mjerë, sepse... nuk zgjodhën rastin për të qenë pranë sunduesit dhe pjesë e logorisë së tij! Institucione të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat monitorojnë Shqipërinë, disa herë, fuqishëm, janë përpjekur ta gjejnë mesin e artë në politikën shqiptare dhe duket se nuk kanë njohur si duhet trashëgiminë gjenetike shqiptare, atë të mercenarizmit. Dhe të sunduesit! Sunduesi i këtyre 30 vjetëve bëri të zakonshme sundimin e quaj-

tur demokraci; mashtrimin si provë gjenialiteti, vjedhjen si dinakëri, kapjen e shtetit si pushtet suprem i domosdoshëm, sovranitetin si lojë fjalësh!

Liderët e tashëm kanë më dëshirë që masat të fillojnë e të tërbohen, të godasin, të pushtojnë, dhe arsyeja të errësohet, sesa të qeverisin pas mendimit dhe idesë!

Tri të katërtat e parlamentarëve janë anonimë! Liderët janë të njëjtët, por vatha e tyre ka ndryshuar! Brenda tufës së liderëve mbetet i paprekshëm vetëm sunduesi i tyre! Hosana për të!

Secili që merr pushtetin, nga lider kthehet në sundues!

Përpara vullnetit të sunduesit parlamentet, qeveritarët, zyrtarët nganjëherë bëjnë ndonjë vërejtje të përlur, ndonjëherë murmuritin, por kurrë nuk kundërshtojnë!

Atëherë, çfarë na duhen 140 murmuritës deputetë, 20 ministra, nja 50 zëvendës të tyre, drejtorë të mëdhenj e të vegjël, kur pakkush mendon me kokën e tij dhe të gjithë tundin kokën si e tund sunduesi?!

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 e kanë ligjësuar sundimin e Njëshit mbi turmën, i kanë zaptuar mendjet, kanë vendosur pushtetin suprem të Njëshit mbi mendjet e pavarura dhe largimin e tyre.

Kjo ka ndodhur shpeshherë, por kurrë si në 30 vjetët e fundit! Sepse tani, si kurrë më parë, liria është shpallur ligjësuar e lirë, por praktikisht është e burgosur! Viti 2008 ngriti prangimin e lirisë dhe legjitimoi Njëshin, sunduesin!

Viti 2020 duhet ta fillojë heqjen e prangave! Të bëjë njerëzor njëshin dhe ta heqë sunduesin! Është e vështirë të kemi menjëherë Prijësin, por le të kthehemi, të paktën, te lideri!

Kusari-Lila kërkon ndaljen e ndërtimeve rreth liqenit të Badovcit

PRISHTINË, 12 JANAR (ER) - Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, ka reaguuar pas ndërtimeve që janë duke u bërë rreth Liqenit të Badovcit, duke thënë se abuzimet në Kosovë me lumenj kanë eskaluar në format më banale të mundshme. Ajo nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka kërkuar që të ndalen menjëherë këto ndërtime. "Në një shtet ku sundon ligji hapësirat e uzurpuara rreth liqenit lirohen. Abuzimet në Kosovë me lumenj kanë eskaluar në format më banale të mundshme, ndërsa rreth liqeneve kanë filluar me liqenin e



Radoniqit e tash po synohet të vazhdohet me Badovcin. Duke shpresuar se njëherë do të jemi edhe ne shtet normal dhe duke

mos dashur të shohim demolime të tilla, ndërtimet duhet të ndalen menjëherë!", ka shkruar Kusari-Lila.

Banorët e Koretinit kundërshtojnë reformën në arsim

KAMENICË, 12 JANAR (ER)

- Dhjetëra banorë të Koretinit në Kamenicë janë mbledhur të dielën në shkollën e fshatit për të diskutuar për reformën në arsim, ku faza e dytë e kësaj reforme preket edhe shkollën e këtij fshati. Reforma në fjalë është kundërshtuar nga një numër i madh i prindërve të cilët kanë thënë se nuk do t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollën e



Topanicës. Ndërkohë në Koretin banorëve u është ofruar një peticion kundër reformës në arsim të cilën e ka nisur kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati.

Autoritetet iraniane ndalojnë ambasadorin britanik

LONDËR, 12 JANAR - Në një postim në "Twitter" të dielën ambasadori i Britanisë në Iran, Rob Macaire, shkruante se ai ishte ndaluar për një kohë të shkurtër nga autoritetet në Teheran të shtunën në mbrëmje pasi mori pjesë në një ceremoni për t'i nderuar viktimat e avionit ukrainas.

Duke dënuar veprimin e autoriteteve për të ndaluar ambasadorin, sekretari i Jashtëm britanik Dominic Raab tha se Irani "mund të vazhdojë marshimin e tij drejt izolimit ose

të ndërmarre hapa për shuarje të tensioneve dhe të angazhohet për zgjidhje diplomatike". Ministri për Sigurinë Brandon Lewis, tha se Britania dëshiron që Irani të luajë rolin e tij në botë, por nuk komentoi posaçërisht nëse do të kishte ndonjë përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj Teheranit.

Richard Ratcliffe, bashkëshorti i Nazanin Zaghari-Ratcliffei punonjëse e një fondacioni që mbahet e burgosur në Iran, tha se rritja e tensioneve rajonale e ka bërë situatën e tyre personale

shumë të brishtë.

Zaghari-Ratcliffe, menaxhere e projektit e Fondacionit Thomson Reuters, u arrestua në prill të 2016-s në një aeroport të Teheranit përpara se të nisej për në Britani me vajzën e saj për një vizitë familjare.

Ajo u dënua nën akuzat për komplot për të rrëzuar institucionet e klerit në Iran, një akuzë e mohuar nga familja e saj dhe Fondacioni, një organizatë bamirësie që vepron në mënyrë të pavarur nga Thomson Reuters dhe agjencia e lajmeve Reuters.



Protesta antiqeveritare në Iran, thirrje kundër udhëheqësit suprem

Pasi u zbulua se qeveria pati gënhyer për disa ditë rresht përpara se të rrëfente të vërtetën, shtyu qindra njerëz në disa qytete të Iranit të dalin në protesta, duke kërkuar dorëheqjen e udhëheqësit suprem Ajatollahut Ali Khamenei dhe hodhën thirrje si "poshtë mashtruesit" dhe "vdekje diktatorit"

TEHERAN, 12 JANAR - Irani ka mobilizuar në kryeqytet forcat speciale të policisë, ndërsa vendi përballet me një tjetër ditë protestash pas lajmeve se zyrtarët iranianë gënhyen për rrëzimin e avionit ukrainas.

Demonstratat u zhvilluan të shtunën në disa qytete iraniane, pasi ushtria pranoi se pati rrëzuar gabimisht avionin.

Zyrtarët iranianë treguan të vërtetën mbi rrethanat e rrëzimit të avionit, vetëm pasi u bë e qartë se provat e mbledhura në terren, nuk do t'i lejonin më të vazhdonin të gënjenin, thuhej në një nga gazetatat kryesore amerikane. Në një postim në "Twitter" të dielën presidenti Donald Trump paralajmëroi Teheranin të mos sulmojë demonstruesit. "Për udhëheqësit e Iranit, mos i vrisni protestuesit. Me mijëra tashmë janë vrarë apo burgosur nga ju dhe bota po shikon. Më e rëndësishmja është që SHBA-ja po ju sheh. Rivini në funksionim

përsëri internetin dhe lini që gazetarët të lëvizin të lirë! Ndaloni vrasjen e popullit tuaj të madh iranian!", shkruante presidenti amerikan.

Avioni u rrëzua të mërkurën, por për disa ditë Irani nuk tha asgjë se ishte një raketë iraniane ajo që kishte goditur avionin, duke vrarë të gjithë 176 pasagjerët. Por të shtunën autoritetet në Teheran e pranuan më në fund përgjegjësinë.

Zbulimi se qeveria pati gënhyer për disa ditë rresht përpara se të rrëfente të vërtetën, shtyu qindra njerëz në disa qytete të vendit të dalin në protesta. Ata kërkojnë dorëheqjen e udhëheqësit Suprem Ajatollahut Ali Khamenei dhe hodhën thirrje si "poshtë mashtruesit" dhe "vdekje diktatorit".

Të shtunën, Garda Revolucionare Islamike e Iranit pranoi se rrëzoi gabimisht avionin e Linjës Ndërkombëtare Ukrainase.

Komandanti i forcave ajrore të



Gardës, Amir Ali Hajizadeh u shpreh në televizionin shtetëror se "merrte përgjegjësinë e plotë dhe se do t'i bindej çfarëdolloj vendimi që do të merrej". Ai shtoi se do të kishte dashur më mirë të "kishte vdekur" sesa të mësonte lajmin mbi atë që i ndodhi avionit. "Atë natë ishim në gatishmëri të plotë për luftë", tha ai dhe shtoi se Garda Revolucionare kishte kërkuar që të anuloheshin fluturimet komerciale, por kërkesa ishte refuzuar.

Sipas një raporti në gazetën "The New York Times", zyrtarët iranianë u detyruan të thonë të vërtetën "sepse provat për godit-

jen me raketë ishin bërë tepër e qartë për hetuesit ndërkombëtarë".

Një zyrtar ukrainas i tha gazetës se ekspertët ukrainas kishin mbledhur informacion në vendin e përplasjes "me gjithë përpjekjet e dukshme të iranianëve për të ndërluar hetimin, madje edhe duke i mbledhur stivë mbetjet, në vend që t'i dokumentonin me kujdes".

Rrëzimi i avionit Boeing 737 ndodhi vetëm pak orë pasi Irani zhvilloi një sulm me raketa balistike ndaj bazave irakiane ku ndodhen forcat amerikane, si reagim ndaj një sulmi ajror

amerikan me dron javën e kaluar që vrau komandantin e Forcave Quds, gjeneral Qassem Soleimani.

Ukraina tha se fluturimi drejt Kievit ishte nisur si zakonisht dhe se ekuipazhi nuk ishte informuar për sulmet me raketa balistike.

Oleksiy Danilov, zyrtari ukrainas që drejton hetimet në vendin e përplasjes, i tha gazetës "The New York Times" se iranianët nuk mund të vazhdonin të gënjenin për rrethanat pasi "hetuesit ukrainas gjetën fragmente në pjesën e lartë të kabinës së avionit, të cilat ishin shpuar nga copëzat e një raketë".

Inteligjenca izraelite ndihmoi ShBA-në në operacionin për vrasjen e Soleimanit

TEL-AVIV, 12 JANAR - Izraeli ka ndihmuar Shtetet e Bashkuara në operacionin e vrasjes së udhëheqësit të fuqishëm të njësisë elitare Quds të Iranit, gjeneral Kassem Suleimanit, njoftoi të dielën rrjeti televiziv amerikan NBC.

Shteti Hebre thuhet se ishte përfshirë në operacionin e 3 janarit, duke iu siguruar informacion amerikanëve.

Inteligjenca izraelite konfirmoi informacionin e dhënë nga transportuesit e aeroportit sirian se Suleimani hipi në avion atë natë duke fluturuar nga Damasku për në Bagdad. NBC citon dy burime të njohura

me operacionin dhe zyrtarë amerikanë pa emër.

Ndërsa avioni zbarkoi, katër raketa u qëlluan nga një dron në automjetin në të cilin hyri gjenerali.

Mediet izraelite raportuan një ditë pas sulmit se Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo kishte njoftuar kryeministrin e Izraelit Benjamin Netanyahu për planet e SHBA-së për të vrarë Sulejmanin.

Pompeo e thirri Netanyahu më 1 janar dhe e falënderoi për mbështetjen e Izraelit në konfliktin me Iranin dhe pas sulmit ndaj ambasadës amerikane në Irak.



Të nesërmen në mëngjes, para se të nisej për në Athinë, Netanyahu

la të kuptohej se "shumë gjëra dramatike" po ndodhin në rajon.

Disa orë më vonë, Sulejman dhe komandanti i milicisë irakiane të mbështetur nga Irani dhe disa zyrtarë të tjerë të lartë u vranë, dhe mediet izraelite dhe "New York Times" raportuan se Netanyahu ishte i vetmi udhëheqës i huaj që e dinte për operacionin.

Më herët agjencitë raportuan se shumë agjentë sirianë dhe iranianë dyshohet se u kishin dhënë amerikanëve informacione që çonin në vrasjen e Suleimani, përfshirë dy rojë sigurie në aeroportin e Bagdadit dhe dy punonjës të linjës ajrore private Siriane, Ham Wings.

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,

We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,

Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net

THIMI MITKO DHE FILLIMET E SHKENCËS SË ALBANOLOGJISË



Prof. dr. Begzad BALIU

Kompleksiteti i studimit të jetës dhe veprës

Në studimet e gjertanishme albanologjike Thimi Mitko shquhet si njëri prej personaliteteve më të veçanta, ndërsa vepra e tij ende e panjohur në përmasat e kompleksitetit të saj. Një konstatim të tillë e mbështesim në studimet e gjertanishme të jetës dhe veprës së tij. Në rrafshin e parë, hynë njohja e plotë e veprimtarisë së tij, e kategorizuar thjesht si një tregtar i vogël, në rrafshin e dytë hynë vlerësimet për mbledhësin e folklorit, si një pasionant dhe jo e gjithë veprimtaria e tij dhe sidomos të gjitha arkivat albanologjike që lidhen me aktivitetet e tij; dhe në rrafshin e tretë, i cili mund të konsiderohet më i rëndësishmi, hynë qasjet metodologjike ndaj punës së tij, përkatësisht pamja kryesisht nacionale e jetës dhe veprimtarisë së tij brenda Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, në vend se ta shohin atë si pjesë përbërëse të Lëvizjes Europiane, e cila u manifestua edhe në Ballkan dhe në Lindje të tij. I lindur në Korçë dhe i shkolluar në një shkollë fillore në gjuhën greke, Thimi Mitko hyri në jetën kombëtare jo si rilindësit e tjerë me formim në Lagjen e shkollës së provinencës franceze të Zosimesë, të provinencave Lindore të Stambollit, të shkollave fetare të proveniencës italiane apo austriake të Shkodrës, apo të ndonjë qendre të ngulitjeve shqiptare në Rumani, ndër arbëreshët e Italisë etj., prandaj rruga e formimit të tij është e veçantë, po aq sa janë të veçanta orientimet e disa prej përfaqësuesve të caktuar të Rilindjes Kombëtare, prej të cilëve shquhet posaçërisht Konstantin Kristoforidhi. Orientimi i tij në jetën kombëtare të Rilindjes Shqiptare prandaj, nuk do të shquhet as prej koncepteve idealiste të brezit të tij, as prej koncepteve perëndimore të përfituara në ndonjërin prej

shkollave me profil euro-amerikan të Janinës a Stambollit, as prej polemikave thjesht etno-historike dhe fetare të fërkimeve ballkanike.

Jetën e tij, tjetër nga bashkëkohësit e tij të Lëvizjes Kombëtare dhe sidomos nga pasardhësit e tij të kësaj Lëvizjeje, do ta formojnë para se gjithash trashëgimia familjare prej zejtarësh, të cilën Thimi Mitko shpejt do ta avancojë në një përmasë tjetër, nga një tregtar i vogël i angazhuar në rrjetet transballkanike (Korçë, Manastir, Janinë, Selanik, Athinë, Bukuresht etj) në fillim, në një tregtar të përmasave transkontinentale (Vjenë, Venedik, Trieshtë, Stamboll, Aleksandri etj.). Në të vërtetë sikur e ka theksuar tash së voni studiuesja Natali Clayer "Thimi Mitko dhe Dora d'Istria ishin dy personalitetet më të rëndësishme në zemër të këtij rrjeti. Me origjinë nga një familje e borgjezisë së re tregtare korçare, Mitko (1820-1890) kishte qenë rrobaqepës, pastaj ishte hedhur në tregtinë ndërmjet Ballkanit dhe Evropës" (Clayer: 2012, 210)


Thimi Mitko dhe revolucionin borgjez i gjysmës së parë të shekullit XIX

Aktivitetet e tij tregtare dhe sigurisht përkushtimi i tij ndaj dijes, të cilën e kishte shfaqur që në fëmijëri kur qe regjistruar në një shkollë në gjuhën greke në Korçë, do të bëjnë që ai të mësojë në qendrat e mëdha të Europës jo vetëm për zhvillimet ekonomike e tregtare, por edhe për zhvillimet politike dhe arsimore, shkencore e intelektuale, të cilat tashmë po kulmonin pas Revolucionit Francez rreth gjysmës shekulli më vonë. Në shekullin XIX dhe në shekullin XX, siç do të shprehet Eric Hobsbawm po zhvilloheshin dy nacionalizma: "I pari, nga viti 1830 deri më 1870 është një nacionalizëm demokratik, masiv dhe politik "i kombeve të mëdha", që buron nga idealet e Revolucionit Francez. I dyti, karakteristik për periudhën nga viti 1870 deri më 1914, ndryshe nga i pari, është një nacionalizëm i ngushtë etnik apo gjuhësor, reagim i kombësive të vogla, kryesisht midis popujve periferikë në zona shpesh të prapambetura, ndaj formacioneve politike anakronike të perandrive osmane, habsburge dhe

cariste". (Smith: 2009, 22). Kjo është edhe arsyeja pse Thimi Mitko fillimisht do t'i takojë nacionalizmit të periudhës së parë dhe aktivitetin e tij do ta zhvillojë brenda "nacionalizmit demokratik të kombeve të mëdha", e kjo do të thotë, se duke u mbështetur në prirjen e filozofëve, shkrimtarëve dhe intelektualëve të shumtë të Europës për të shquar trashëgiminë e lashtë dhe paneuropiane të qytetërimit helen, jo vetëm përkrahu alfabetin grek për shkrimin e gjuhës shqipe, por edhe vetë deri në "periudhën e dytë 1870", kur u shfaq "nacionalizmi i ngushtë etnik apo gjuhësor", çfarë ishin nacionalizmat grekë dhe pansllavë, botoi tekste në gjuhën shqipe me alfabetin grek, duke përfshirë këtu edhe kryeveprën e tij "Bleta Shqiptare".

Ky fakt përjashton një prirje të studimeve të derivona albanologjike, sipas së cilave një pjesë e rilindësve shqiptarë fillimisht ishin nën ndikimin e kulturës greke dhe u vetëdijesuan vetëm pas zhvillimeve luftarake popullore kundër Perandorisë Osmane. Përkundrazi, janë disa nga rilindësit shqiptarë, ata të cilët, të parët u informuan me zhvillimet politike, ekonomike dhe kombëtare të Europës, dhe kësaj lëvizjeje ju bashkuan pavarësisht faktit se intelektualët e Europës gjuhën dhe kulturën greke e romake i kishin vendosur në themelet e trashëgimisë evropiane. Ky "nacionalizim i ngushtë etnik dhe gjuhësor", nga platforma e Magali Idesë dhe disa qarqeve sllave e greke, do të përpiqet që të përdoret për të shuar përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për të zgjuar vetëdijen historike, etnike dhe gjuhësore të tyre në dobi edhe të lirisë dhe pavarësisë.

Në të vërtetë prej dijes së zënë në rrethet tregtare, arsimore dhe shkencore të shkollave europiane Thimi Mitko do të njihet me disa nga konceptet bashkëkohore të kohës për vlerat dhe orientimet e kombeve të përparuara, për të cilat mund të ishin të informuar disa nga bashkëkohësit e tij ndër arbëreshët e Italisë, por jo edhe bashkëkohësit e tij në atdhe dhe përgjithësisht në Ballkan e në Lindje, mbase me përjashtim të Konstantin Kristoforidhit. Në qendrat politike, ekonomike, arsimore dhe intelektuale të Europës Thimi Mitko do të mëso-



Thimi Mitko dhe Lëvizja herderiane europiane

je jo vetëm për zhvillimet më të reja politike, por edhe për ndikimin që kishin ato në zgjimit e reja kombëtare të popujve të mëdhenj, përkatësisht për përlindjet e mëdha kombëtare, që shfaqeshin në qendrat më të mëdha të Europës bashkë me zhvillimet teknologjike dhe ekonomike, në të vërtetë bashkë me revolucionin borgjez të fillimit të shekullit XIX. Thimi Mitko do të ketë fatin të jetojë një kohë të gjatë në Europë dhe të angazhohet në Lëvizjen Kombëtare pikërisht në këtë periudhë të fillimit të shekullit XIX, kur sikur shprehet historiani Patrik Geary, historia u konceptua dhe u zhvillua si instrument i nacionalizmit evropian. (Geary: 2009, 45) Prej zhvillimeve të kohës Thimi Mitko do të mësojë konceptet e reja orientuese të popujve të mëdhenj, e këto sikur do të theksojë tash së fundit Anthony D. Smith ishin "nacionalizmi perëndimor: ideologjia, gjuha dhe ndjenjat sentimentale" (Smith: 2010, 116), të formuluar në konceptet kombëtare dhe shtetërore për autonomi, identitet, shpirt kombëtar, autenticitet, bashkimi e vëllazërim, brenda të cilave qëndronte gjuha e bashkuar dhe diskursi që ka simbolet e veta ceremoniale dhe shprehëse (Smith: 2010, 124).

Në këto qendra europiane, sikur ishin Vjena, Parisi, Berlina e ndonjë tjetër, Thimi Mitko do të mësojë jo vetëm për arritjet shkencore të tyre, por edhe për ndikimin që kishin ato në zhvillimet politike, arsimore dhe kulturore në periferi të Europës dhe në mënyrë të veçantë në Ballkan dhe përgjithësisht në Europën Juglindore. Për kohën e tij, këto koncepte më parë se sa Europës i përgjigjeshin Ballkanit, përkatësisht shqiptarëve të ndarë në zona administrative perandorake, në besime fetare dhe në zona të ndikimit grek e sllav. Ishin pikërisht shqiptarët më parë se sa sllavët apo grekët që kishin nevojë të dinin konceptet e filozofit gjerman Lajbnic për një "shoqëri të përkatësisë gjermane" (Thiess: 2004, 42). E vërteta, këtë lëvizje e projektonin më së miri konceptet e Herderit, sipas të cilit disa lëvizje "si psh., pansllavizmi, ishin politizuar lehtësisht, dhe të gjitha kombet që do të bëheshin, i realizuan këto lëvizje sipas aparateve të tyre të vetë-krijimit kombëtar. Këto aparate përfshinin korpusin e "monumenteve të historisë kombëtare" dhe filologjinë (shumica e filologëve ishin të arsimuar në Gjermani) për të

ndriçuar origjinat e lashta të kombeve të tyre. Studimet e tyre dhe nacionalizimi u bënë një". (Geary: 2009, 68). Nuk është e rastit pse më parë se sa shumë bashkëkohës të tij, me këtë lëvizje herderiane do të "politizohet lehtësisht" edhe Thimi Mitko.

Studimet e gjertanishme albanologjike mbase me të drejtë e kanë theksuar faktin se Thimi Mitko jo vetëm nuk kishte dhunti prej vjershëtari, por nuk ishte as filolog i formuar, prandaj i gjithë kontributi i tij mbetet në nivel të një botuesi të folklorit, por studimet albanologjike kanë lënë mënjanë disa faktorë të tjerë të rëndësishëm të angazhimit të tij në këtë drejtje, e këta janë: njohja e mirë e zhvillimeve filologjike të kohës, të cilat ai i merrte në dy drejtime, përmes informacionit mjaft të plotë të Vjenës dhe disa qendrave të tjera të kohës dhe përmes komunikimit që kishte me disa nga bardët më të shquar të kulturës kombëtare, sikur ishin rilindësi me dhunti letrare Jeronim de Rada dhe studiuesi me formim filologjik Dhimitër Kamarda. Ndryshe nuk mund të shpjegohet, thjesht, vetëm si pasion angazhimi i tij në mbledhjen e krijimtarisë popullore, përdorisa kemi një botim të plotë filologjik të kryeveprës së tij "Bleta shqiptare", të cilën më parë se sa një vëllim tekstesh popullore, në "Parathënien" e tij e quan një vëllim "studimesh albanologjike". (Mitko: 1980, 61).

Kishte më shumë se një shekull që kur bardi i një lëvizjeje të madhe kombëtare Herder tërhiqte vërejtjen se "në Evropë ka ende një sërë kombesh të lëna në braktisje. (...) E megjithatë, kujtonte ai, ka midis tyre disa persona, funksioni i të cilëve është të studiojnë gjuhën, zakonet, mënyrat e të menduarit, besëtytnitë e vjetra dhe doket e kombit të tyre! Dhe sikur ta bënin këtë, do t'ju jepnin kombeve të tjera gramatikën më të gjallë, fjalorin më të mirë dhe historinë natyrore të popullit të tyre". (Thiesse: 2004, 46). Prandaj, a mund të quhet e rastit "Parathënia" e vëllimit të tij, "Bleta shqiptare", e cila hapet me tekstin programatik dhe me të cilin lexuesve ua kujtonte se "Qëllimi i "Bletës shqiptare", (...) është përgjithësisht, shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë, i fjalëve dhe i teksteve shqipe, të cilat (...) besoj se do të kenë një vlef të sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare" (Mitko: 1980, 61). Në këtë rrjedhë, konstatimi se Thimi Mitko këtë vepër e quajti vëllim me "studime albanologjike", për të përmbushur idenë e tij për një revistë antologjike, sikur janë shprehur studiuesit e gjertanishëm, nuk më duket shumë i qëndrueshëm. Për Thimi Mitkon nuk ishte problem nxjerrja e një reviste të tillë, për faktin se ai kishte mjete financiare dhe rrethe shkencore e kulturore për një synim të tillë. Më parë se idenë e një reviste në këtë botim do parë konceptet fillestare herderiane

për folklorin dhe gjuhën, si dhe arritjet filologjike e botimet e kësaj natyre në shkencën europiane. Këtë funksion e kanë jo vetëm tekstet folklorike të të gjitha llojeve dhe gjinive, por edhe fjalësi përshkrues, duke përfshirë këtu edhe antroponimet e patronimet e hapësirës shqiptare, me të cilat në esencë vuri themelet shkencore të albanologjisë mbi onomastikën. Dhe jo vetëm kaq, ndikimi i mendimeve të Herderit në konceptet historike, shkencore dhe letrare të Thimi Mitkos për rëndësinë që kishin vazhdojnë edhe te bashkëkohësit dhe sidomos 'pasardhësit' e tij me përkushtimin e tyre ndaj traditës dhe folklorit. Nëse sipas Herderit "poetia popullore asht pasqyra e shpirtit e t'nimeve t'nji fisit", sipas Spiro Dinës "kangët tona janë shumë të nevojshme e të vjetruara për kombin tonë, se ndër këto shikojmë të ngjarat e çdo kohe, që ka shkuar si valët e detit. Prej këtyre mund të dal një histori e plotë" (Sipas, Pirraku: 1989, 337-338)

Sikur ka vënë re Anna Marie Thiesse "çështja e gjuhës, zë një vend qendror në refleksionin herderian. Për të, në gjeninë e gjuhës ndodhet shpirti i kombit" (Thiesse: 2004, 43), prandaj nuk është e rastit pse edhe Thimi Mitko citon mendimin e Herderit në "Parathënien" e tij, sipas të cilit "një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet", (Mitko: 1980, 61) ndërsa Mitko këto premisa paradigmatisht e shtrinte edhe më tej në dy drejtime themelore të pazgjidhura për kohën: politike dhe gjuhësore. Në premisën e parë shihet alfabetin si akt politik, prandaj edhe kujtonte se "në qoftë se lihet Shqipëria në padijen e saj, pa shkronja vendi dhe pa shkolla të popullit, atëherë sllavët me mjete më të forta e më praktike do të shpejtojnë për të gëlltur racën shqiptare" (Mitko: 1980, 62); ndërsa në premisën e dytë shihet pikërisht gjuhën, e cila për Mitkon ishte "ushqim i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit" (Mitko: 1980, 62), ashtu sikur ishte edhe për Herderin "shprehje e gjallë, organike e shpirtit të një populli, shuma e veprimtimit efikas të të gjithë shpirtave njerëzorë që e kanë përbërë përgjatë shekujve". (cit., sipas Thiesse: 2004, 44).

Thimi Mitko dhe europianizimi i albanologjisë

Prej dijes së gjertanishme albanologjike nuk është vështirë të shihet se Thimi Mitko nuk kishte formim albanologjik, në përmasën që e kishin disa nga bashkëkohësit dhe pasardhësit e tij të Rilindjes Kombëtare, por prej aktiviteteve dhe bëmave e tij nuk mund të mos thuhet se atij nuk i mungonte informacioni për filologjinë, historinë dhe kulturën shqiptare. Ndryshe prej bashkëkohësve dhe sidomos pasardhësve të brezit të tij të

Lëvizjes Kombëtare të shekullit XIX, Thimi Mitkos nuk i mungonte jo vetëm dija për kulturën dhe qytetërimin shqiptar e ballkanik po as për zhvillimet filologjike shumë me ndikim në gjithë Europën, një lëvizje që po përhapej si dije historike, kulturore, shpirtërore dhe identitare edhe në Ballkan edhe në Lindje, në Perandorinë Osmane.


Nuk është e rastit, që pjesë e kësaj njohjeje dhe e kësaj lëvizjeje bëhen me kohë studiuesit dhe shkrimtarët e radhës së arbëreshëve, por jo edhe intelektualët, studiuesit dhe shkrimtarët e radhës së shqiptarëve të Ballkanit dhe atyre në Lindje, me ndonjë përjashtim të rastit, sikur ishte Konstantin Kristoforidhi. Thimi Mitko do t'i bashkohet kësaj lëvizjeje si një intelektual i përkushtuar, prandaj në këtë mënyrë do ta manifestojë edhe aktivitetin e tij: me letërkëmbim të dendur, me dërgimin e teksteve letrare dhe shkencore kur në gazeta dhe revista të kohës e kur në formë të përshkruara, me mbledhjen e trashëgimisë etno-historike dhe gjuhësore kombëtare dhe botimin e saj në institucionet më të njohura akademike të Europës, ashtu sikur vepruan bashkëkohësit e tij nga Ballkani etj. Në këtë mënyrë, mund të themi se Thimi Mitko, më parë se sa të bënte albanologjinë, për të cilën i duhej formimi filologjik i Dhimitër Kamardës dhe më parë se sa të bënte letërsinë, për të cilën i duhej dhuntia e Naim Frashërit

apo e Jeronim de Radës, e bëri popullarizimin e albanologjisë. "Në planin e afirmimit kombëtar të popullit shqiptar, theksonte historiani Muhamet Pirraku, "Bleta shqiptare" e kreu detyrën e një armate kombëtare të pathyeshme të Rilindjes. Ajo u bë burim interesimesh shkencore e politike për dijetarët më në zë evropianë të kohës. Drejtori i organit akademik Acta Comparationum Litterarum variarum, këngët historike të botuara në Bletën shqiptare i quante "poezi të mirëfillta politike" dhe e stigmatizonte Kongresin e Berlinit të vitit 1878, duke theksuar me ironi se "çfarë parimesh mund të përligjin vendimet e këtij Kongresi, që i mohon një populli me tradita të tilla të drejtën e ekzistencës" (Pirraku: 1989, 518). Dhe jo vetëm kaq.

Duke mbledhur një thesar të tërë të folklorit shqiptar (nga ninullat deri te këngët historike dhe nga përrallat deri te tekstet tregimtare), duke mbledhur njësi leksikore (nga fjalësi historik i gjuhës shqipe deri te leksiku i përditshëm vendor dhe i huaj); duke pranëvënë antroponiminë dhe patroniminë shqipe të besimeve të ndryshme, si dhe strukturat gramatikore e semantike të tyre, Thimi Mitko kreu atë mision të cilin një shekull më parë e kishte caktuar Herderi për popujt e mëdhenj evropianë; ndërsa duke e botuar atë në revista me përmasa europiane që botoheshin në gazetatat në gjuhën greke në Ballkan, në revistat arbëreshe,

në revistat akademike europiane në gjuhën gjermane dhe sidomos në vëllimet albanologjike më me ndikim në studimet filologjike europiane, Thimi Mitko jo vetëm popullarizoi, por edhe e europianizoi dijen albanologjike, në ato përmasa për të cilat shkenca e sotme e albanologjisë nuk e ka dhënë vlerësimin e saj. Dhe nuk e ka bërë këtë, kryesisht për dy shkaqe: prej qasjes metodologjike ndaj biografisë vetjake të Thimi Mitkos, si personalitet me biografi prej borgjezi të vogël, dhe prej mosnjohjes së veprave, dorëshkrimeve dhe arkivave të plota, të shtrira në Lindje, ndër arbëreshët dhe në Europë. Kur studimet albanologjike, e kjo do të thotë kur albanologjia të vlerësohet jo vetëm si dije historiko-gjuhësore dhe si kontribut historiko-letrar, por edhe si lëvizje intelektuale, roli i Thimi Mitkos do të dalë në plan të parë: si rol i intelektualit që në një periudhë shumë të rëndësishme të përlindjes historike, kulturore, gjuhësore dhe shpirtërore të Europës, Ballkanit dhe hapësirës shqiptare, me angazhimin e shumanshëm të tij bashkonte strukturat e shpërndara të Lëvizjes Kombëtare ndërmjet Ballkanit, Kolonive brenda Perandorisë Osmane, arbëreshëve të Italisë dhe qendrave shkencore, kulturore e arsimore, që përtej misionit shkencor e kulturor në Europë kishin rolin e orientimeve politike dhe strategjike të shteteve të tyre ndaj popujve të vegjël në periferi të saj.





Salvador Dalí: A mos jam gjení vallë?

Në moshën gjashtë vjeç doja të bëhesha kuzhinier. Në moshën shtatë vjeç, Napoleon. Edhe më vonë dëshirat e mia shtoheshin jo më pak sesa synimi për t'u ngjitur sa më lart drejt madhësisë

Në ditarin e Stendalit përmenden fjalët e njëfarë markeze italiane, e cila, në një mbrëmje vere me vapë përvëluese, kishte provuar akulloren: "Sa keq që kjo nuk është një kënaqësi mëkatore!". Kështu pra, kur unë isha gjashtë vjeç, ishte mëkat i madh të haje bukë në kuzhinë. E kisha të ndaluar nga prindërit të hyja në atë pjesë të shtëpisë. Mbaj mend që, duke kapërdirë jargët, gjeja rastin të depërtoja në sancta sanctorum (vendin e shenjtë), domethënë në vendin e kënaqësive të papërfytyrueshme. Megjithatë, ndonjëherë arrija të hyja atje, i ndjekur nga britmat e shërbyeseve... Dhe, ndonëse më kërcënonte ndonjë shuplakë e mirë, me shpirt ndër dhëmbë,

rrëmbeja ose ndonjë copë mishi, ose ndonjë kërpudhë të skuqur dhe, në kulmin e ngazëlimit, dilja me vrap, gjë që e rëndonte edhe më tepër fajin. Çdo gjë tjetër më lejohej. Ndërsa të hyja në kuzhinë, në asnjë mënyrë. Deri në moshën tetë vjeç shkruaja duke ndenjtur shtrirë në shtrat, vetëm e vetëm sepse ashtu më pëlqente. Në shtëpi isha unë që mbretëroja e jepja urdhra. Për mua nuk kishte asgjë të pamundur. Babai dhe nëna vetëm që nuk faleshin përpara meje. Ditën e Infantës, midis dhuratave të shumta, mora edhe një kostum të mrekullueshëm mbretëror, një pelerinë të qëndisur me lëkurë të vërtetë kunadheje dhe një kurorë prej ari me gurë të

çmuar. E kam ruajtur për një kohë shumë të gjatë atë vërtetim të shkëlqyer (ndonëse si në maskaradë) të të qenit i zgjedhuri i familjes. Mbaj mend se shërbëtoret ruanin syçelë që gjëja e ndaluar për mua të mos shkelej në asnjë mënyrë, kështu që, sa më pikasin, më zbonin... Dhe ja, unë po rrija si i nguros në gjysmerrësirën e korridorit, i veshur me rrobat mbretërore, në një dorë mbaja skeptrin, ndërsa në tjetrën, që më dridhej vazhdimisht, një kamxhik: isha gati t'i fshikulloja ato kafshë në mënyrë që ta merrnin vesh se me mua nuk mund të talleshin! Skena të tilla luheshin zakonisht afër mesditës, në atë orë sflitëse të verës, kur në ajrin që nuk të mjafton për të mbushur mushkëritë, fillojnë e lindin vegime. Fshihem pas derës gjysmë të hapur të kuzhinës dhe dëgjoj se si vrapojnë, me sa kanë fuqi prapa meje, ato gra-kafshë me duar të kuqërremta, shoh trupat e tyre të fuqishëm dhe jelet e shpupuritura. Në vapën e mesditës, midis zhurmës së shurdhët të përgatitjeve të drekës, arrin deri tek unë duhma e

thartë e djersës së grave, e kokrave të rrrushit, e vajit të nxehtë, e qimeve të hequra nga lëkura e lepujve të butë, e veshkave dhe e majonezës, që e mbulojnë aromën e gjellëve, dhe të gjitha këto bashkohen e bëhen njësh duke më krijuar ndjesinë e erës së kalit. E bardha e rrahur e vezës, që shkëlqen si rreze dielli, shpërthen nëpërmjet shtëllungave të tymit dhe resë së mizave duke ndriçuar pikërisht si shkuma që u del kuajve, të cilët, pas një vrapimi të gjatë nëpër rrugën e pluhurosur, fshikullohen deri në përgjakje. Siç edhe e thashë, unë kam qenë fëmijë i llastuar e i mbrapshtë...

Vëllai im vdiq tre vjet përpara se të lindja unë, në moshën shtatëvjeçare, nga meningjiti. Babai dhe mamaja ime e ngushëlluan dëshpërimin e tyre me ardhjen time në jetë. Unë me tim vëlla ngjanim si dy pika uji: po ato fillesa gjenialiteti (më vonë, në vitin 1929, mua m'u shfaq vetëdija e prerë e gjenialitetit dhe, ndonëse u përforcua shumë brenda meje, nuk më shkaktoi asnjë shenjë nga ajo që quhet mani e mad-

hëstisë) dhe po ajo shprehje e shqetësimeve të kota. Ne daltonim vetëm në disa tipare psikologjike. Jo vetëm kaq, por edhe vështrimin ai e kishte pasur të ndryshëm, si të mbështjellë nga melankolia, nga një meditim "i pakapërcyeshëm". Unë nuk isha dhe aq i mençur dhe, si për ta plotësuar këtë, më ishte dhënë aftësia të reflektoja për gjithçka. U bëra reflektues i shkallës më të lartë për shkak të "polimorfizmit tim të shtrembëruar",* si dhe i prapambetjes fenomenale në zhvillim. Meqenëse më ishin ngulitur në tru disa kujtime të turbullta nga parajsja me prejardhje erotike të fëmijës së gjirit, me një kryeneçësi prej egoisti, kapesha fort pas kënaqësive. Në këtë fushë nuk hasja në kundërshtime, prandaj edhe bëhesha i rrezikshëm. Një mbrëmje, sesi i gërvishta me gjilpërë faqen tajësime, vetëm e vetëm sepse shitorja ku ajo më çonte për të blerë ëmbëlsirat e mia të dashura ishte e mbyllur. Kështu pra, nuk kishte dyshim që unë isha një fëmijë plot gjallëri. Vëllai im ishte vetëm prova e parë e vetesime, që ishte ngjizur tek unë

me tepricë absolute.

Tani ne e kemi të qartë që forma është rezultat i dhunës prej inkuizitori mbi materien. Hapësira e shtyp atë nga të gjitha anët, kështu që materies i duhet të mbrohet dhe të tendoset, të arrijë deri në kufijtë e mundësive të saj. Kushedi sa herë, materia e frymëzuar nga vrulli i tepricës absolute, vdes, zhduket? Edhe materia më e aftë për t'u përshtatur, që është shumë më e thjeshtë në kërkesat e saj, i kundërvihet tiranisë së hapësirës, duke u rrekur t'i përmbahet thelbit të formës së saj origjinale. A ka gjë më të lehtë, më të lirë dhe më me fantazi se ngjyrimet e kristaleve minerale? Por edhe ato janë prodhim i "mjedisit koloidal" të përqendruar, i cili, duke i munduar, i mbërthen dhe i përmbledh në një strukturë të ngurtë. Degëzimet më të përkryera dhe më ajrore janë vetëm e vetëm një grafik i agonisë, i vuajtjeve të dëshpëruara, i frymëmarrjeve të fundit të materies, e cila vdes, por nuk dorëzohet, është ngjyrimi i fundit i botës së mineraleve. Por edhe për trëndafilin, ligji është po ai! Çdo lule bulëzon nën trysni. Liria është pa formë. Morfologjia (lavdi Gëtes që e ka shpikur këtë fjalë i ngazëllyer nga pafundësia krijuese e Leonardos), pra morfologjia na zbulon se, krahas mbretërisë fitimtare të hierarkisë së ngurtë të formave, ka edhe prirje më anarkike dhe më të ndryshme në lloje, të cilat gërryhen nga kundërshtitë.

Në këtë mënyrë mendjet e ngushta e të kufizuara u dogjën nga zjarret e Inkuizicionit të Shenjtë, shpirtat heterogjenë dhe anarkikë mbartën mbi vete pasqyrimin e zjarrit të madhërisëm të morfologjisë së tyre shpirtërore. Siç e përmenda, vëllai im kishte pasur aftësi meditimi të një vetie të veçantë, të papërballueshme, e paaftë të ndryshonte pamje dhe që ndrydhte vetveten. Ndërsa unë, si e kundërta e tij, isha një shturje polimorfe, e gjallë dhe anarkike. Të gjitha veprimet e mia të vetëdijshme shpreheshin në makutërinë time, dhe e gjithë makutëria bëhej një veprim i vetëdijshëm. Gjithçka ma ndryshonte pamjen dhe asgjë nuk ma ndryshoi thelbin. Unë kam qenë i plogët, frikacak dhe kundërthënë. Në ashpërsinë e mendimit spanjoll, natyra ime kërkonte shfaqjen më të madhërisme të kristaleve të gjalla, të përsosura dhe trillane të gjenialitetit tim të papërsëritshëm. Prindërit më pagëzuan Salvador, ashtu si tim vëlla. Dhe, nga kuptimi i emrit, mua më ishte paracaktuar, as më shumë e as më pak, por të shpëtoja Pikturën nga paqenësitë e modernizmit dhe kjo do të ndodhte në epokën e katastrofave, në atë gjithësi mekanike e të zakonshme, në të cilën ne, për fat të mirë dhe për fat të keq, jetojmë. Sikur të kisha mundësi të gjen-

desha në të Kaluarën, Rafaeli dhe të ngjashmit me të do të më dukeshin perëndi të vërteta. Ka të ngjarë që unë të jem i vetmi njeri që e kam kuptuar se pse sot është e pamundur t'u afrohem formave rafaeliane. Krijimtaria ime, mua vetë më duket një fatkeqësi e madhe. Si mund të jetoja unë në epokën time, kur nuk do të kisha mundësi të shpëtoja dot asgjë! Por duke u kthyer tek e Tanishmja e quaj ogur të mirë që shumë mjeshtra i kam vlerësuar më tepër se veten, por, megjithatë, nuk do të doja të ndërroja vendin me asnjërin nga ata që sot janë gjallë.

Ta arrish dhe ta shprehësh kuptimin e jetës i vetmuar do të thotë të krahasohesh me titanët e mëdhenj të Rilindjes. E tillë është gruaja ime Gala (Elena Dmitrievna Djakonova, me prejardhje ruse), e cila qe lumturi për mua. Lëvizjet e saj fluturake, gjetet dhe aftësia për t'u shprehur, i ngjajnë Simfonisë së Dytë: shfaq tiparet arkitektonike të shpirtit të përkryer, që kristalizohet në begatinë e vetë trupit, në aromën e lëkurës, në shkumën detare të shndritshme të jetës së saj. Duke shprehur frymëmarrjen e stërholluar të frymëmarrjes së ndjenjave, plastika dhe aftësia e të shprehurit materializohen në arkitekturën e patëmetë prej mishi e gjaku.

Kur Gala pushon, mund të them se i ngjan kishëzës Tempio di Bramanti, që ndodhet në afërsi të Shën Pjetrit Montozio, në Romë. Dhe ashtu si Stendali në Vatikan, unë më vonë, dhe pavarësisht prej tij, mund të vë në një rrafsh krenarinë e saj, kolonat e bukura, parmakët e butë e të qëndrueshëm, me pamjen fëmijërore të saj, shkallët hyjnore me buzëqeshjen e saj. Orë të tëra përpara këmbalecit të piktorit, duke e admiruar vjedhurazi, në kohën kur ajo nuk e vinte re këtë, unë i thosha vetes se ajo është një tablo po aq e bukur sa punimet e Vermejerit dhe të Rafaelit. Në një kohë që të tjerët, ata që na rrethojnë, na duken të vizatuar aq dobët, të skalitur aq dobët, saqë ngjajnë më tepër me karikaturë të pështira, të laparosura në ngut e sipër nga ndonjë piktor i uritur në tarracën e ndonjë kafeneje.

Në moshën shtatëvjeçare unë doja të bëhesha si Napoleoni... Ja se si ndodhi. Në katin e dytë të shtëpisë sonë banonin argjentinasit Mammas. Njëra nga vajzat e asaj familjeje, me një bukuri përrallore, Ursula Mammas, sipas zërave që u dëgjuan, u bë katalanasja e vitit 1900. Flitej gjithashtu se Eugenio d'Ors, në librin e vet "La Ben Plantada" ("Shtathedhura"), pamjen e kata-lanasës e kishte pikturuar duke u nisur nga fytyra e saj. Në vitin tim të shtatë më kaploi joshja seksualo-aristokratike ndaj katit të dytë. Gjatë buzëm-

brëmjeve të ngrohta, unë rrija për orë të tëra në tarracë, derisa fëshfërima sipër, që me zor ndihej, më tregonte se mbi mua po hapej dera e ballkonit. Në katin e dytë më donin aq sa edhe në shtëpinë time. Rreth orës gjashtë të mbrëmjes, përreth tavolinës monumentale në sallon, mbi të cilën qëndronte varur një i balsamosur lejlek, mbledheshin për të pirë mate disa zonja të mahnitshme, me flokët të fryrë dhe që flisnin me theks argjentinas. Mate-në e shërbenin në një enë të madhe argjendi, e cila kalonte nga njëra buzë te tjetra. Ajo afërsi e ngushtë buzësh më emociononte dhe më lindte në shpirt një qerthull i tërë pasionesh, në të cilin fillonin të shndrisnin majat e mprehta të xhelozisë.

Kur më vinte radha, edhe unë e gjerbja lëngun e ëmbël, që përshijet time ishte më i ëmbël se mjalti, ndërsa mjalti, më i ëmbël se gjaku. Sepse ime më, gjaku im, ishte gjithmonë po aty. Në këtë mënyrë, fillesa ime aristokratike ishte një marshim tri-

umfal nga buzët në buzë, nga goja në gojë, kështu që unë doja të pija kupën e Napoleonit, pasi Perandori ndodhej gjithashtu në sallonin e katit të dytë, ndonëse jo personalisht, gjithsesi, aty ndodhej përfytyrimi i tij në faqen e një fuçie të vogël druri, në të cilën ruhej mate-ja. Ai Napoleon me rëndësi olimprike, me barkun e bardhë e të ngopur, me faqet e tij perandorake të trëndafilta, me kapelë të zezë, i përgjigjej pikë për pikë përfytyrimit tim të asaj se çfarë monarku mund të isha unë vetë.

Në atë kohë ishte në modë kënga:

Napoleon en el final

De un ramillet colossal.

Paraqitja e Napoleonit në faqen e fuçisë e kishte përpirë përfytyrimin tim, po aq të egër sa edhe e bardha e vezës në pjatë (apo ndoshta pa pjatë). Dhe i ndikuar nga Napoleoni i pijshëm, nëpërmjet mate-së ndodhi një kërcim i fortë i joshjeve të mia, nga kuzhinieri deri tek perandori. Pikërisht në këtë mënyrë, ndje-

sitë e mia erotike të grave-kuaj, që ecnin me galop nëpër kuzhinën tonë, u nxorën jashtë fushës sime të pamjes nga përfytyrimi i shndritshëm i Ursula Mammasit, i bukuroshes të llojit të vitit 1900. Më vonë do t'i përshkruaj me hollësitë e "maknës që mendon" zbulimet e mia. Njëra prej tyre, të paktën, është e bazuar në idenë e Napoleonit të pijshëm, në të cilin u mishëruan dy fantazmat e fëmijërisë sime të hershme. Jermi i buzëve (gojëve) dhe imperializmi i verbër shpirtëror. Kjo e shpjegon se pse pesëdhjetë kupa me qumësht të ngrohtë, të vendosura mbi një karrige të lëkundshme, ishin për mua një lloj si kofshët buçkane të Napoleonit. Për ta përfytyruar një gjë të tillë, nuk duhet të jesh i çmendur! Kjo shprehej edhe në sende të tjera, që, të para në dritën e këtij libri, nuk janë më pak të çuditshme dhe më të pakundërshtueshme. Gjithsesi është e vërtetë: gjithçka, absolutisht gjithçka që them këtu, është tërësisht mëkati im, mëkati im i vetëm./Exlibris

Përktheu Guri SHYTI



E rrallë

Kina vë në qarkullim "trenin si plumb"

Kina kohët e fundit ka zbuluar një tren të ri, i cili pritet ta lidhë Pekinin me qytetin e Zhangjiakou, ku do të mbahen shumë prej ngjarjeve të Lojërave Olimpikë Dimërore të vitit 2022. Sipas medieve të huaja, treni i ri me shpejtësi të lartë



do ta zvogëlojë kohën e udhëtimit midis dy qyteteve, nga tri orë në vetëm 47 minuta.

BARSOLETA E DITËS



Në restorant:
Amerikanët: Thanks!
Gjermanët: Dankeschon!
Francezët: Merci!
Shqiptarët: Kamerier, a bën edhe pak bukë?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Bukuri nga stina e dimrit, te kroi te Rrasa e Zogut.

E jashtëzakonshme

Zgjidhet misteri i zërit të çuditshëm që u dëgjua në të gjithë botën

Një zë misterioz që u dëgjua në të gjithë botën më në fund është zgjidhur. Shkencëtarët thanë se tingulli që njerëzit e dëgjuan ishte pjesë e një liqeni të mbushur me magmë në Oqeanin Indian. Tingulli i çuditshëm ishte dëgjuar disa muaj më parë dhe po bezdiste ata që e dëgjuan. Dhe tani thuhet se një vullkan i ri nënujor që shfaqet midis Madagaskarit



dhe Mozambikut, në brigjet e ishullit Mayotte, ishte pas tij. Studimi thotë se magma nga një rezervuar rreth 20 milje poshtë fundit të oqeanit udhëtoi lart për ta formuar vullkanin e ri, diçka që ishte shumë e zëshme.




DASHI

Do të jeni dinamik dhe shkëlqyes, do ta veçoni aftësinë tuaj për të shijuar çdo çast.



DEMI

Të zemëro-hesh është pothuajse e pashmangshme. Mund ta irritoni partnerin tuaj.



BINJAKËT

Lajmet që po prisni po vijjnë, nuk ka nevojë t'i kërkonit ato. Jeta në çift kërkon më shumë vëmendje.



GAFORRJA

Tërhiqni telat e çantës, në këtë moment ju piren të shpenzoni shumë lehtë. Saktësisht pastroni një keqkuptim të trashë me partnerin.



LUANI

Ju jeni mbështetur nga miq, të inkuruar nga Hëna në shenjën tuaj. Për sa i përket detyrave, sot mund të paguani pak.



IRGJËRESHA

Bëni ditët tuaja më kuptimplotë. Dëshironi më shumë çaste angazhuese me partnerin tuaj.



PESHORJA

Ditë e gëzuar: Ditën e sotme do të ketë shumë gjallëri dhe shumë mundësi që nuk duhen humbur.



AKREPI

Hëna dhe Venusi ngadalësojnë rrugën tuaj sot. Në fakt, ju dukeni pak të lodhur dhe të pamotivuar.



SHIGJETARI

Sharmi dhe komunikimi i bukur janë pikërisht ato që duhen për të nxjerrë në pah në fushën sociale.



BRICJAPI

Përmirësoni mirëkuptimin e çiftit dhe do ta demonstroi atë, duke e mbushur partnerin tuaj me vëmendje të vogla dhe të mëdha.



UJORI

Do të jetë një ditë e fshehtë për marrëdhëniet personale që mund të përjetojnë momente kritike. Qëndroni të qetë!



PESHQIT


Do të jetë një ditë e qetë, por nuk mund të qëndroni gjithë kohës në dafina. Duhet ta organizoni jetën tuaj të përditshme dhe mënyrën tuaj të të ushqyerit ndryshe.

Zayn Malik konfirmon ribashkimin me Gigi Hadidin



Zayn e Gigi u ndanë për herë të fundit në nëntor të vitit 2018, mirëpo çifti duket se janë të lumtur që janë përsëri bashkë, shkruan "Daily Mail". Çifti i ribashkuar u panë të shtunën në mbrëmje në Nju Jork, ndërsa ata dolën për ta festuar ditëlindjen e Zayn me motrën e Gigit, Bella Hadid, nënën e tyre Yolanda Hadid, si dhe me ta ishte shqiptarja

Dua Lipa. Gigi dhe Zayn konfirmon romancën e tyre për herë të parë në nëntor të vitit 2015 kur u panë duke mbajtur duart me njëri-tjetrin. Ylli i muzikës pop kohët e fundit kishte përfunduar një lidhje me Perrie Edvard, teksa Gigi ishte ndarë nga Joe Jonas. Pavarësisht se nuk ishin bashkë, të dy mbetën miq gjatë gjithë vitit të kaluar.



Rita Ora shfaqet plot stil në Miami

Ajo është një nga këngëtares më të famshme. Rita Ora, përveç famës si këngëtare, është e njohur edhe për stilin e veçantë në veshje. Ajo së fundmi është parë e veshur plot stil

derisa po dilte nga një hotel në Miami. 29-vjeçarja i është përshtatur mjaft mirë motit të ngrohtë të Miamit, e veshur me një palë xhinse dhe një bluzë të zezë prej mëndafshi.

Jennifer Lopez, imazhi i kampanjës së re së "Versace's"



Jennifer Lopez ka bërë me dije se është bërë imazh i kampanjës së re të "Versace"-s. Ajo e konfirmoi këtë përmes fotografive që i ka realizuar nga fotosesioni për këtë brend. "Jam e emocionuar që

më në fund mund t'ju njoftoj se jam fytyra e kampanjës 'VersaceSS20'. Faleminderit Donatella Versace dhe çdonjërit të 'Versace' për vizionin tuaj dhe bashkëpunimin", ka shkruar ajo.

Mbretëresha shihet për herë të parë pas lajmit bombastik të largimit të Harryt dhe Meghanit

Pas lajmeve bombastike të largimit të Princ Harryt dhe Meghan Markle nga familja mbretërore, Mbretëresha Elizabeth është parë të dalë jashtë me veturën e saj "Land Rover" dhe një shami në kokë. Ajo që kaloi Krishtlindjet në Sandringham së fundmi ka udhëzuar ndihmësit e saj të Pallatit Mbretëror që ta ndihmojnë nipin e saj Princin Harry dhe



gruan e tij të gjejnë një "zgjidhje të realizueshme" për rolet e tyre në të ardhmen.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Kosova humbet miqësoren në të cilën shkëlqeu

Kosova e humbi ndeshjen miqësore kundër Suedisë (1-0), por fitoi shumë futbollistë për të ardhmen. Përzgjedhësi i "dardanëve", Bernard Challandes, e shfrytëzoi këtë ndeshje për t'u dhënë rast lojtarëve nga Superliga e Kosovës, të cilët për mrekulli e shfrytëzuan një gjë të tillë. Këta futbollistë dominuan në ndeshje dhe krijuan shumë raste shënimi, por fati nuk ishte në anën e tyre

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll pësoi humbje në ndeshjen miqësore kundër Suedisë (1-0), e cila është zhvilluar në Doha të Katarit. Pavarësisht kësaj humbje, "dardanët" patën paraqitje shumë të mirë ndaj një kundërshtari të fortë, i cili kësaj radhe përbëhej nga lojtarë të ligës vendore. Vetëm katër minuta lojë u deshën Kosovës që të rrezikojë për herë të parë portën e suedezëve, por Ibrahimaj gjuajti lart. Në minutën e 17 Kosovë pati një rast të mirë, por Bytyqi nuk e ndali mirë topin dhe aksioni përfundoi pa rezultat. Rastin më të mirë "dardanët" e regjistruan në minutën e 22-të kur, pas një harkimi të mirë të Shalës, me kokë gjuajti Kastrati, por portieri suedez ishte në vend. Një minutë më vonë nga afër-

sia nuk arriti ta dërgojë topin në rrjetë kapiteni Fidan Aliti. Trembëdhjetë minuta më vonë Suedia shënoi, por në mënyrë të parregullt. Në fund të pjesës së parë, Kosova rrezikoi fillimisht nëpërmjet Rashanit, goditja e të cilit u bllokua nga mbrojtësit suedez, derisa të pasuksesshëm në finalizim ishin edhe Kastrati dhe Bytyqi. Në minutën e 54-t Arbër Hoxha pati rast që t'i kalojë "dardanët" në epërsi, por gjuajtja e tij është bllokuar. Suedia pas një ore lojë e mori kontrollin e lojës dhe arriti në minutën e 75-të të kalojë në epërsi me anë të Simon Hedlund. Një minutë më vonë Kosova u mundua të kundërpërgjigjet, por parabola e Jetmir Topallit nuk përfundoi në rrjetën e portierit suedez. Suedia pati edhe dy raste të mira shënimi në minutat në vijim, por Bekaj nuk lejoi që të pësojë gol

tjetër dhe ndeshja përfundoi me rezultat 1-0. Përzgjedhësi Challandes për këtë ndeshje kishte ftuar për herë të parë trembëdhjetë lojtarë të Superligës së Kosovës, derisa nëntë nga këta futbollistë patën rastin të paraqiten. Ky ishte testi i fundit për Përfaqësuesen e Kosovës para ndeshjes gjysmëfinale në Ligën e Kombeve që zhvillohet në muajin mars në Shkup kundër Maqedonisë së Veriut. Për Kosovën titullarë ishin Visar Bekaj, Armend Thaqi, Fidan Aliti, Lirim Kastrati, Herolind Shala, Zymer Bytyqi, Florian Loshaj, Flamur Kastrati, Ylldren Ibrahimaj, Elbasan Rashani, Leotrim Bekteshi. Ndërsa në lojë janë inkuadruar edhe Ismet Lushaku, Jetmir Topalli, Valmir Veliu, Blend Baftiu, Arbër Hoxha, Lapidar Lladrovci, Anel Rashkaj, Rron Broja dhe Arb Manaj.

SHKURT

Ballkani prezanton Dakun

Kampionia vjeshtore e IPKO Superligës së Kosovës në futboll e ka prezantuar sulmuesin Mirlind Daku i cili në sezonin vjeshtor ishte huazuar nga NK Osjek në skuadrën e Kukësit. "Futbollisti më i ri FC Ballkani është sulmuesi shtatllartë Mirlind Daku, i cili vjen në formë huazimi nga klubi mik NK Osjek - Kroaci. Mirlindi është anëtar i rregullt i Përfaqësueses U21, i cili më parë ka mbrojtur ngjyrat e klubeve të Superligës, duke qenë protagonist në KF Hajvalia, KF Llapi dhe në ligën superiore të Shqipërisë te KF Kukësi. Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimi e Ballkanit.

Ferizaj fillon përgatitjet

Skuadra e Ferizajt i ka filluar të dielën stërvitjet për sezonin pranveror në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Stërvitjet i ka udhëhequr trajneri Bekim Isufi, i cili do të jetë trajner i kësaj skuadre edhe në pjesën e mbetur të kampionatit 2019/2020. "Në stërvitje kanë marrë pjesë të gjithë lojtarët dhe u pa një atmosferë shumë e mirë brenda klubit. Ndërsa shumë shpejt pritet të vijnë edhe disa transferime të reja në klubin tonë", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

Rashica shënon në miqësore

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica, ka shënuar golin e parë në miqësoren që Werder Bremani e fitoi ndaj Hannoverit 96 (3-1). Anëtori nga Vushtrria e realizoi golin e tretë për skuadrën e tij në pjesën e dytë për rezultatin final 3-1.

Ajeti pas Tiranës kërkohet edhe nga Shkëndija

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Arlind Ajeti, është në shënjestrën e disa klubeve shqiptare. Përveç Tiranës që ka shprehur hapur interesim për qendërmbrojtësin kuqezi, në garë është futur edhe kampionia e Maqedonisë së Veriut, Shkëndija e Tetovës. 26-vjeçari ka mbetur pa skuadër që prej korrikut të vitit të kaluar kur ndërpreu bashkëpunimin me Grashoperin. Por, futbollisti po kërkon që të luajë gjithmonë në Evropë dhe aktivizimi me ndonjë klub shqiptar do të jetë alternativa e tij e fundit. Ajeti ishte njëri prej futbollistëve më të spikatur të skuadrës sonë kombëtare gjatë eliminatoreve historike dhe kampionatit evropian 2016, ku në fitoren historike ndaj Rumanisë u shpall edhe "Njeriu i ndeshjes".

'Dardanët' triumfojnë ndaj Gjeorgjisë

PRISHTINË, 12 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll e ka mbyllur me fitore fazën e parë kualifikuese për Botërorin 2021. Kosova të dielën e mposhti Gjeorgjinë me rezultat 30:21 (18:13), në takimin e luajtur në Benevento të Italisë. Të dielën hendbollistët e Kosovës ishin të vendosur

për fitore dhe kanë dhënë maksimumin për ngjyrat e fanellës. Ndonëse ndeshja nisi keq për "dardanët", lojtarët e strategut Taip Ramadani nuk janë dorëzuar dhe shpejt janë kthyer në lojë. Në mes të pjesës së parë Kosova kaloi në epërsi, kurse kjo epërsi është rritur shumë në pjesën e dytë. Mbrojtja

ishte e pakalueshme, ndërsa edhe në sulm ishin shumë efikas. Në këtë mënyrë Kosova e ka mbyllur me fitore turneun kualifikues në Itali dhe ka bërë hapin para drejt synimit. Kosova në ndeshjen e parë kishte barazuar me Italinë (26:26), ndërsa të shtunën humbi nga Rumania 21:32 (7:15).



Shoqata e Futbollistëve do ta ndihmojë financiarisht portierin e diagnostifikuar me tumor

PRISHTINË, 12 JANAR - Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës është sensibilizuar me rastin e portierit të Trepçës '89, Arben Beqiri, i cili vuan nga tumori në stomak. Ky organizëm ka vendosur të kontribuojë financiarisht nëpër-

mjet donacioneve vullnetare për t'i mbuluar shpenzimet e kurimit të 31-vjeçarit. Lajmi është konfirmuar po nga SHMDFK-ja. "Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me bordin e saj po shqyrton

mundësitë për ta ndihmuar Arben Beqirin, portierin e Trepçës '89. Shoqata ka kontaktuar me Arbenin për ta harmonizuar këtë iniciativë. Arbeni është diagnostifikuar me tumor në stomak dhe ka nisur kimioterapinë. Shoqata fton të gjithë komunitetin

futbollistik që t'i dalë në ndihmë Arbenit dhe ta përkrahë përgjatë kësaj sfide. Në ditët në vazhdim do t'ju njoftojmë me informacione shtesë për veprimet që do të ndërmerim", thuhet në njoftimin e SHMDFK-së.



Shala pas operimit: Vitin tjetër do ta përfaqësoj Kosovën

PRISHTINË, 12 JANAR - Skitarja e Kosovës, Era Shala, me sukses e ka kaluar operimin, pas thyerjes së këmbës gjatë përgatitjeve të para të garave të Lojërave Olimpikë Dimërore për të Rinj "Lozana 2020". Era po trajtohet në njërin prej spitaleve më të mira në Zvicër, CHUV.

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka vizituar të dielën skitarin Era Shala. Era theu këmbën e majtë, për çka iu desh që të kryejë rreth tri orë operim. Hasani në emër të Lëvizjes Olimpikë në Kosovë i uroi shërim sa më të shpejtë dhe rikthim në garat e skitarisë, sport ky të cilin e do. "Era po mbahet shumë mirë. Edhe në këtë aksident që e ka pasur kishte fat sepse, sipas mjekëve, një lëndim i tillë ka mundur të ketë pasojë në karrierën e saj të ardhshme, andaj pritet që pas një periudhe të caktuar kohore të shërohet në tërësi dhe t'iu kthehet shtigjeve të skijimit dhe besoj se do të kemi shumë medalje nga Era", ka thënë Hasani. "Po ndihem më mirë



pas lëndimit të rëndë. Të shtunën isha në trening, kur u rrëzova dhe theva këmbën. Pastaj më kanë dalë në ndihmë menjëherë trajnerët dhe ka ardhur shërbimi emergjent i Zvicrës, i cili më ka marrë me helikopter dhe më ka sjellë këtu në spital, për çka e falënderoj shumë. Jam operuar dhe tani po rikuperohem këtu. Kujdesi është shumë i mirë", u shpreh Shala për "noc-kosovo.org". 16-vjeçarja është dashur të debutojë të dielën për Kosovën në disiplinën e sllallomit të madh në

skijimin alpin. "Kam pritur shumë këtë moment, por ja që fati deshi të mos jem në gara. Normalisht se jam e dëshpëruar, por unë nuk do të ndalem, do të synojë ta përfaqësoj Kosovën edhe në vitin e ardhshëm", ka shtuar Shala. Në fillim të vitit të ardhshëm do të mbahet Festivali Olimpik Dimëror Evropian (EYOF) në Vuokati të Finlandës. Në LOD për të Rinj Lozana 2020 po merr pjesë edhe skitari Drin Kokaj, i cili do të debutojë sot (e hënë) në sllallom të madh.

Lakersat fitojnë ndaj Oklahomas

OKLAHOMA, 12 JANAR - Los Angeles Lakers ia del të fitojë edhe pa dyshen James-Davis. Skuadra kaliforniane triumfoi me rezultat 110-125 në "Chesapeake Energy Arena" ndaj Oklahoma City Thunderit, duke regjistruar suksesin e tetë radhazi dhe të 32-tin në këtë sezon të NBA-s. Lakersat, praktikisht, e hipotekuan suksesin që në periodën e parë, me një rezultat të pjesshëm 19-41, pra duke shënuar më shumë se dyfishin e pikëve të kundërshtarit. Lider i padiskutueshëm i kalifornianëve rezultoi Kyle Kuzma, autor i 36 pikëve, ndërka Rajon Rondo e mbylli takimin duke iu afruar "triple double"-it: 21 pikë, 12



"rebounde" e 8 asistime. Fitore e lehtë për Houston Rocketsin, që në "Toyota Center" iu imponua me rezultatin e thellë 139-109. Minnesota Timberwolvesit. 32 pikë, 12 "rebounde" dhe 8 asistime për James Hardenin, që bëhet lojtari i shtatë më i ri në historinë e NBA-s që arrin kuotën e 20 mijë pikëve. "Double double" edhe për Russel Westbrookun që, përveçse shënoi 30 pikë, dha edhe 10 asistime. Edhe Boston Celticsi shkatërroi 140-105 në "TD Garden" New Orleans Pelicansin. Paraqitje

për t'u mbajtur mend nga Jayson Tatum, që shënoi plot 41 pikë, çka përbën edhe rekordin e karrierës së tij. Ndërkohë Milwaukee Bucks, skuadra më e mirë e Lindjes, fitoi pa vështirësi në "Moda Center" të Portlandit 101-122 ndaj Trail Blazersit. Një ndeshje e kontrolluar nga fillimi deri në fund nga miqtë, te të cilët spikati Giannis Antetokoumpo, MVP i sezonit të kaluar, me 32 pikë e 17 "rebounde", i ndihmuar edhe nga Khris Middleton dhe Eric Bledsoe, respektivisht me 30 dhe 29 pikë.

SHKURT

Caldara largohet nga Milani

Mattia Caldara është larguar nga skuadra e Milanit, pasi nuk ka arritur të gjejë hapësira dhe ai ka vendosur të rikthehet në skuadrën e Atalantas. Atalanta e ka marrë atë në formë huazimi për 18 muaj me të drejtë blerje në fund të vitit 2021. Mbrojtësi ka kryer testet mjekësore dhe ka nënshkruar kontratë, kurse Atalanta duhet të paguajë 15 milionë euro në vitin 2021.

Wernerit në verë e refuzoi Liverpoolin

Ylli i RB Leipzigut dhe Kombëtares së Gjermanisë, Timo Werner, kishte mundësinë që t'i bashkohet skuadrës së Liverpoolit gjatë verës. Anëtar i Leipzigut duket se ka kalkuluar shumë para vendimit të tij dhe në fund vendosi të mos kalonte në "Anfield". "DailyStar" shkruan se Wernerit refuzoi mundësinë për t'iu bashkuar Liverpoolit, pasi nuk dëshironte të rrinte në stol. Vera e ardhshme mund ta finalizojë transferimin e Wernerit te liderët aktualë të Premierligës.

IBF-ja ultimatum Joshuas dhe Pulevit

Boksierët Anthony Joshua dhe Kubrat Pulev kanë afat deri më 31 janar për të negociuar për duelin e mundshëm mes tyre, sfidë e vlefshme për titullin kampion bote në peshën e rëndë. Negociata që kanë të bëjnë me datën dhe përqindjen e fitimit. Pulev është i mandatuar nga IBF për të dueluar për titullin kampion në këtë kategori. Problem për Joshuan është se edhe ukrainasi Oleksandr Usyk është i mandatuar për të dueluar për titullin kampion bote, këtë herë të kategorisë WBO. Gjithsesi, kjo e fundit ende nuk ka dhënë një ultimatum, çka lë të mendosh se Joshua do t'i mbrojtë titujt fillimisht ndaj bulgarit Pulev e më pas, në rast se fiton, ndaj Usyk. "Negociatat mes Joshuas dhe Pulevit do të mbyllen më 31 janar. Ky është afati i vendosur. Ne dëshirojmë që palët të gjejnë një zgjidhje, në të kundërt do të vendosim ne për këtë sfidë, duke marrë masa", thanë drejtuesit e IBF-së. Ndërsa Usyk pritët të duelojë më 28 mars ndaj Dereck Chisora.

Ibra bën humor: Nëse fitojmë kampionatin, rinovoj me Milanin

Zlatan Ibrahimović u rikthye te Milani pas thujse tetë sezonesh dhe gjeti golin e parë në ndeshjen e tij të dytë, duke vulosur triumfin e kuqezinjve ndaj Cagliariarit. "Shënoj, festoj si zot dhe ndihem më i ri. Pioli shqetësohet disi për moshën time, por mendja ime është e njëjta dhe fiziku thjesht duhet ta ndjekë. Kam nevojë për më shumë ndeshje, që ta gjej ritmin e duhur, por ndihem mirë gjithsesi. Nëse fitojmë kampionatin, mund edhe të rinovoj me Milanin", ka thënë Ibrahimović. "Punua gjatë javës për këtë skemë të re dhe na shkoi mirë, pasi fituam në një fushë të vështirë. Tani duhet të vazhdojmë kështu, për t'u përmirësuar edhe më shumë. Unë e nisa ndeshjen me disa gabime, por me kalimin e minutave po ndihesha më mirë dhe përmirësohesha. Pastaj erdhi goli, që është mjaft i rëndësishëm për një sulmues", ka shtuar Ibrahimović.

Xavi, afër ta marrë drejtimin e Barcelonës

Xavi do të jetë trajneri i ri i Barcelonës, raporton "Goal", derisa aventura e Ernesto Valverdes në "Camp Nou" është drejt fundit. Sipas këtyre raportimeve, thuhet se mesfushori legjendar ka qenë në bisedime të rregullta ditët e fundit me drejtorin gjeneral të Barcelonës, Oscar Grau dhe sekretarin teknik Eric Abidal. Nuk pritët të ketë ndonjë konfirmim zyrtar para se Al-Saddi, klubi aktual i Xavit, ta zhvillojë ndeshjen finale të Kupës së Katarit, më 17 janar. "Nuk mund ta fshej, kjo është ëndrra ime. Ëndërroj të jem trajner i Barcelonës, e kam thënë në shumë intervista. Të gjithë e dinë se e mbështes Barcelonën nga thellësia e shpirtit, prandaj po, është një nga ëndrrat, por unë jam i fokusuar në Al-Sadd. Unë e respektoj Barcelonën, Valverden dhe klubin tim aktual, prandaj nuk mund të them asgjë më shumë", ka thënë Xavi.

REZULTATET

Houston Rockets - Minnesota Timberwolves	139-109
Boston Celtics - New Orleans Pelicans	140-105
Detroit Pistons - Chicago Bulls	99-108
Oklahoma City Thunder - Los Angeles Lakers	110-125
Dallas Mavericks - Philadelphia 76ers	109-91
Denver Nuggets - Cleveland Cavaliers	103-111
Portland Trail Blazers - Milwaukee Bucks	101-122



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Službe Kosova (UBKSK)- Hospital and University Clinical Service
of Kosovo (HUCSK)

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, nenit 13 paragrafi 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar e Kosovës, (SHSKUK), në bazë të nenit 17 të Statutit të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi, si dhe nenit 5 të Rregullores nr. 1003/2016 Mbi Marrëdhënien e Punës, SHSKUK-së shpall:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Titulli i vendit të punës: Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë
Drejtor Ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë
Raporton: Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së
Kohëzgjatja e kontratës: 3 vjet me mundësi të ri-zgjedhjes edhe për një mandat
Periudha provuese: 90 ditë sipas KKS-së
Koeficienti i pagës: 12.0
Orari i punës: i plotë (40 ore ne javë)
Nr. i Referencës: SHSKUK - 01/2020-01/1

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Udhëheq me punët operative dhe administrative te spitalit
- Koordinon aktivitetet e gjithëmbarshme shëndetësore, financiare dhe administrative të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë si njësi përbërëse organizative e SHSKUK-së
- Monitoron performancën profesionale dhe afarizmin financiar të spitalit
- Mbikëqyr zbatimin e përzgjedhjes së shefave dhe stafit tjetër menaxhues të spitalit në bazë të konkursit në pajtim me ligjin,
- Siguron transparencën ligjore të punës dhe veprimtarisë në spital
- Përgatitë për Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së raporte të rregullta pune (javore, mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore) dhe sipas kërkesës
- Përgatitë për Drejtorin e Përgjithshëm raporte periodike mujore me deklaratën përcjellëse financiare
- Merr pjesë në takimet me Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së
- Ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit për Shëndetësi, ligjeve tjera në fuqi, akteve të brendshme të SHSKUK-së
- Bën vlerësimin e performancës individuale të stafit menaxheria të spitalit
- Përgatitë raporte specifike sipas kërkesës për Drejtorin e Përgjithshëm dhe Bordin Drejtues të SHSKUK-së

Përgjegjësitë kryesore:

- Siguron udhëheqje efektive dhe efikase të spitalit, zbaton politikat e Ministrisë së Shëndetësisë
- Ofron alternativa, udhëzime dhe orientime strategjike të zhvillimit të nivelit dytësor të SHSKUK-së
- Siguron funksionimin e strukturës efikase menaxhuese brenda institucionit dhe në mënyrë të qartë identifikon nivelet e përgjegjësisë dhe obligimet brenda institucionit
- Siguron zhvillimin e të gjitha procedurave dhe politikave të domosdoshme administrative për menaxhimin efikas dhe efektiv në institucion
- Siguron sistemin e rishikimit të brendshëm efektiv duke përfshirë ankesat dhe çështjet legale të bazuara në procedura ligjore, si dhe mundëson raportimin zyrtar të rezultateve
- Siguron implementimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve përmirësuese nga raportet e pranuar nga mbikëqyrja e jashtme dhe e brendshme
- Është nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të drejtorit dhe stafit nën menaxhimin e tij, implementimi i dokumenteve strategjike të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe Bordin Drejtues i SHSKUK-së, si dhe raportimi lidhur me implementimin e tyre
- Siguron procesin e revizionit efektiv në institucion dhe revizione periodike në mënyrë të vazhdueshme, ndan rezultatet, zbaton dhe mbikëqyr veprimet përmirësuese
- Siguron përgatitjen e planit vjetor të biznesit, diskutimin e tij dhe harmonizimin me Drejtorin e Përgjithshëm dhe përmes tij me Bordin Drejtues të SHSKUK-së
- Siguron zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të biznesit të institucionit
- Siguron se institucioni ka përgatitë strategjinë e shërbimit që pasqyron direktivat e strategjisë së përgjithshme shëndetësore të SHSKUK-së
- Siguron zhvillimin e imazhit pozitiv të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, ndërton raporte të mira me publikun dhe mediet
- Siguron transparencë të funksionimit të institucionit, përgatitë, publikon dhe ndan me palët e interesuara raportet vjetore të punës së institucionit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi
- Krijon kushte optimale për punë për stafin e institucionit dhe zhvillon programe konkrete për zhvillimin dhe avancimin profesional të tyre.

Kriteret dhe Shkollimi i kërkuar:

- Të ketë arsim të lartë universitar, thirrje akademik ose të kenë titullin e doktorit të shkencave, magjistër i mjekësisë apo specialist/e në njërin nga degët e mjekësisë
- Të ketë titullin e doktorit të shkencave, magjistër i shkencave juridike, Jurist i diplomuar

- Të ketë titullin e doktorit të shkencave, magjistër i shkencave ekonomike, Ekonomist i diplomuar
- Përparësi me rastin e përzgjedhjes do të kenë kandidatët me kualifikimet veçanta në lëmin e menaxhmentit shëndetësor.

Aftësitë/përvoja dhe dokumentet tjera që kërkohen::

- Së paku pesë (5) vite përvojë pune në sistemin shëndetësor, prej tyre tre (3) vite në pozita udhëheqëse
- Shkathësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike
- Njohja e mirë e sistemit shëndetësor dhe organizimit të punës në institucionet e kujdesit shëndetësor
- Njohuri e legjisllacionit në përgjithësi dhe të atij në fushën e shëndetësisë në veçanti
- Njohuri në fushën e menaxhimit të financave publike
- Aftësi të mira komunikuese në të folur dhe në të shkruar
- Aftësi për punë ekipore
- Njohja e punës me kompjuter (Ëord, Exel etj)
- Njohja e gjuhëve është përparësi
- Certifikatë që nuk jeni i dënuar ose nën hetime lëshuar nga gjykata kompetente
- Letërnjoftim - kopje

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe plotësojnë kriteret e kërkuara me konkurs si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar sipas këtij konkursi.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në njërin nga mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të SHSKUK-së.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Dr Basri Sejdiu

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarsvo Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerziteteske Bolničke i
Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)-The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Prema članku 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, član 4 stav 1,2,3,4,5 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o uređivanju postupaka javnog nadmetanja, članu 13. stavcima 1. i 3. Statuta Univerziteteske bolničke službe i Univerziteteske klinike Kosova (HUCSK), statutu Opšte bolnice u Mitrovici i članu 62. stav 6. Zakona br. 04 / L-125, o zdravstvu, članak 5. Uredbe o radnim odnosima br. 1003, HUCSK objavljuje

KONKURS

Institucija: Univerziteteska bolnica i klinička služba Kosova (HUCSK)
Opšta bolnica u Mitrovica
Naziv radnog mjesta: **Izvršni direktor Opće Bolnice u Mitrovica**

Izvršitelj: **Generalni direktor HUCSK-a**

Trajanje ugovora: 3 godine s mogućnošću ponovnog izbora za još jedan mandat
Probni period: 90 dana prema SNC-u
Koeficijent zarade: 12,0
Radno vrijeme: puno (40 sati sedmično)
Br. reference: HUCSK - 01/2020-01/1

Obaveze i odgovornosti:

- Vodi operativni i administrativni rad zdravstvene ustanove sekundarnog nivoa
- Koordinirati sveukupne zdravstvene, finansijske i administrativne aktivnosti organizacijske jedinice HUCSK
- Prati profesionalne rezultate i finansijske rezultate bolnice
- nadzire provedbu izbora šefova i ostalog osoblja bolničkog menadžmenta na osnovu konkurencije u skladu sa zakonom,
- Osigurava zakonsku transparentnost rada i aktivnosti bolnice
- Pripremite redovna izvješća o radu (tjedno, mjesečno, tromjesečno, šest mjesečno i godišnje) za generalnog direktora HUCSK-a i na zahtjev
- Pripremite mjesečna periodična izvješća s pripadajućim finansijskim izvještajima za generalnog direktora
- Sudjelujte na sastancima na način sa generalnim direktorom HUCSK-a
- Svoju aktivnost obavlja prema Zakonu o zdravstvu, drugim važećim zakonima, internim aktima HUCSK-a
- Procjenjuje individualni učinak bolničkog rukovodstva
- Pripremite posebna izvješća na zahtjev generalnog direktora i odbora HUCSK-a

Glavne odgovornosti:

- Osigurava efikasno i efikasno upravljanje bolnicama, provodi politike Ministarstva zdravlja
- Pružna strateške alternative, smjernice i strateški razvoj sekundarne razine HUCSK-a
- Osigurava funkcioniranje efikasne upravljačke strukture unutar institucije i jasno identifikuje nivo odgovornosti i obaveza unutar institucije
- Osigurava razvoj svih potrebnih administrativnih postupaka i politika za efikasno i djelotvorno upravljanje institucijom
- Omogućuje efikasan sistem interne revizije koji uključuje žalbe i pravna pitanja zasnovana na pravnim procedurama i omogućava službeno izvještavanje o rezultatima
- Osigurava provedbu i nadzor korektivnih radnji iz izvještaja dobivenih od vanjskog i unutarnjeg nadzora
- To je pod izravnom odgovornošću direktora i osoblja pod njegovim upravljanjem, provođenje strateških dokumenata koje su usvojile Vlada Republike Kosovo, Ministarstvo zdravlja i Odbor HUCSK-a, kao i izvještavanje o njihovoj provedbi
- Osigurava učinkovit proces revizije u instituciji i periodične revizije, širi rezultate, provodi i nadgleda korektivne radnje
- Osigurava pripremu godišnjeg poslovnog plana, njegovu raspravu i usklađivanje s generalnim direktorom i putem njega s Izvršnim odborom HACCP-a
- Osigurava razvoj, implementaciju i praćenje poslovnog plana institucije
- Osigurava da institucija priprema strategiju usluga koja odražava opće smjernice zdravstvene strategije HUCSK-a
- Osigurava razvoj pozitivne unutarnje i vanjske slike institucije, gradi dobre odnose sa javnošću i medijima
- Osigurava transparentnost funkcioniranja institucije, priprema, objavljuje i distribuira dioncima godišnje izvještaje o radu institucije u skladu s važećim zakonskim okvirom.
- Stvara optimalne radne uslove za osoblje ustanove i razvija konkretne programe za njihov profesionalni razvoj i napredovanje.

Kriteriji i obrazovanje potrebno:

- Da imate univerzitetSKU diplomu, akademski stepen ili doktorat, magistar medicine ili specijalista iz jedne od grana medicine
- Imati titulu doktora nauka, magistra prava, diplomiranog pravnika
- Imati titulu doktora nauka, magistra ekonomije, diplomiranog ekonomiste
- Prednost u odabiru imaju kandidati sa specijalnim kvalifikacijama iz oblasti zdravstva.

Potrebne vještine / iskustvo i ostali atributi :

- Najmanje pet (5) godina radnog iskustva u zdravstvenom sistemu , od čega tri (3) godine na rukovodećim pozicijama
- Vještine u definiranju i postizanju strateških ciljeva
- Dobro poznavanje zdravstvenog sistema i organizacije rada u zdravstvenim ustanovama
- Poznavanje zakonodavstva uopšte i zdravlja posebno
- Znanje iz oblasti upravljanja javnim finansijama
- dobre komunikacijske vještine u govoru i pisanju
- Veštine timskog rada
- Računalna pismenost (Āord, Exel itd.) \
- Poznavanje jezika je prednost
- Potvrdu da niste osuđeni ili je pod istragom nadležan sud
- Lična karta - fotokopija
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od 3 mjeseca (original)

Uslovi učesća u zapošljavanju: pravo da se prijave svi su državljani Republike Kosova odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje i imaju adekvatnu stručnu sposobnost koje zahteva sa konkursom za obavljanje zadataka.

Zbornik radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate, prema ovom konkursu.

Datum zatvaranja konkursa: **15 dana od dana objavljivanja u jednom od javnih novinama.**

Podnošenje prijave: Aplikacija se uzimaju i dostavljaju kadrovskom odeljenju UKCK.

U prijavi treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Svi profesionalni dokumenata i dokaza prilaže uz zahtev.

Prijave podnete po isteku roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju .

Dr Basri Sejdiu

Generalnog direktora HUCSK-a

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► " VIZIONI INFO " SH.P.K. shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër 601723829.

► Elheme Qorraj shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F "Emin Duraku" Likoc.

► "ASL" SH.PK. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

► Veton Shaqiri, shpall të pavlefshme dëftesat e SHF. "Deshmoret e Qyqavices" Qirez.

► Astrit Shaqiri, shpall të pavlefshme dëftesat e SHF. " Deshmoret e Qyqavices " Qirez

► Lirije Brahimi, shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHF. " Azem Bejta " Prekaz i Eperm.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

